

PJESA E PARË

VEPRIMTARITË KRYESORE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË GJATË VITIT 2012

Gjatë vitit 2012 në veprimtaritë e saj, AShSh ka synuar realizimin e funksioneve kryesore të saj në disa drejtime kryesore:

- Në: bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e Ash-së në realizimin e objektivave të Qeverisë, me pjesëmarrje në këshilla, grupe *ad hoc*, borde, etj;
- këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse;
- bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë, për hartimin e programeve kombëtare e dypalëshe, ekspertizave dhe monitorimeve të ndryshme në shkallë vendi etj.;
- evidentimin e nxitjen e mundësive të aplikimit të produktit shkencor në praktikat prodhuese, koordinimin për vënien në zbatim dhe platformat për zhvillimin e teknologjive të reja;
- propozimin e fushave të reja të kërkimit e studimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor;
- organizimin e kongreseve dhe konferencave shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, mbi problematikat e fushave përparësore të zhvillimit të përgjithshëm të vendit;
- promovimin dhe mbështetjen e *ekselencës*, të kërkuesve të rinj në shkencë në shkallë kombëtare për të realizuar nivele të larta kërkimi dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit;
- krijimin e një infrastrukture të përshtatshme të teknologjive të informacionit me standarde të kohës dhe në përputhje me strukturën e kërkuar për shpërndarjen e informacionit shkencor elektronik, veprimtari e Bibliotekës Shkencore të AShSh-së;

- krijimin e strukturave të reja për bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë me akademitë e tjera, në rajon e më gjerë;

Vlerësimi i zhvillimeve dinamike të veprimtarisë, duke iu referuar krahasimit të treguesve të arritura (që lidhen me aktivitetin kërkimor bazë: aplikativ apo eksperimental dhe fushat e kërkimit; personelin, shpenzimet), evidenton arritje mjaft pozitive krahasuar me ato të një viti më parë.

Treguesit e mëposhtëm përbëjnë rezultatet e ASh-së të arritura në vitin 2011.

Stafi akademik sot përbëhet nga 30 “Akademikë”, (3 të përhershëm), 11 “Akademikë të asociuar” dhe 2 “Akademikë” në politikë, të shpërndarë sipas fushave të kërkimit, si në diagramën e mëposhtme:




Fig. 1. Përbërja e stafit akademik të Ash-së sipas shkencave në vitin 2012

Siç shihet, stafi akademik në vitin 2012 përfshin përfaqësues të shkencave shoqërore e albanologjike (19); dhe në ato natyrore e teknike (22).

Një tregues i përdorur nga institucionet ndërkombëtare është mosha e stafit akademik. Në grafikun e mëposhtëm jepet mosha e “Akademikëve” dhe e “Akademikëve të asociuar” në vitin 2012, krahasuar edhe me atë të vitit 2011.




Fig. 2. Stafi akademik sipas klasave të moshës në vitin 2012, krahasuar me vitin 2011

Treguesit ekonomikë të AShSh-së gjatë vitit 2012 rezultojnë si më poshtë:




Fig. 3. Realizimi i buxhetit sipas zërave

Shpenzimet e kryera me fondet e buxhetit të planifikuara u realizuan 100 %.




Fig. 4. Realizimi *Plan - Fakt*




Fig. 5. Realizimi i krahasuar i Buxhetit

Nga grafikët e mësipërm, vihet re dinamika e realizimit të treguesve ekonomikë, financiarë e atyre monetarë.

Veprimtarinë e saj, AShSh e zhvillon përmes seksioneve të saj, përkatësisht Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe atij të Shkencave Natyrore e Teknike. Është punuar për përcaktimin e kuadrit të përparësive të mbështetjes ekonomike të veprimtarive për kërkim e zhvillim, që ato t'i përgjigjen më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Objektivi i AShSh-së ka konsistuar në vazhdimësi në përmbushjen e përparësive shkencore afatshkurtra, afatmesme e në perspektivë, dhe mobilizimin e shkencëtarëve. Objektivat e AShSh-së janë në përputhje me Strategjinë për Shkencën, Zhvillimin Teknologjik e Inovacionet në nivel kombëtar.

Financimet e buxhetit janë të drejtuara në mbështetje të veprimtarive të kërkimit në fushat shoqërore e albanologjike duke synuar në zgjidhjen me përparësi të problemeve ekonomike, gjuhësore dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë historike, kulturore, shoqërore, demografike etj. Po kështu, mbështetje financiare i është dhënë edhe kërkimit në fushat natyrore e teknike, duke zhvilluar me përparësi fushat e teknologjive të informimit e komunikimit, shëndetit publik, pasurive të burimeve natyrore, pyjeve e menaxhimit të tyre, efektshmërisë energjetike, biodiversitetit, mjedisit etj., të lidhura e në përputhje këto me Programet Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh).

Forcimi i kapaciteteve të ASh-së, e aftë për këshillim të qeverisjes dhe shoqërisë civile, vazhdoi të ishte një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit, në përputhje edhe me përparësitë, për realizimin e të cilave edhe në vitin 2012, ka ecur në përputhje me SKZHTI. Bazuar në fushat përparësore për zhvillimin e vendit, AShSh ka punuar për krijimin e komisioneve të përhershme apo *ad hoc*, duke tërhequr specialistët më të mirë të fushave, për të realizuar studime të rëndësishme të veçantë, kombëtare e më gjerë, të cilat vihen në shërbim të vendimmarrësve. Kësisoj, është vënë në rrugë të mbarë dhe po funksionon Këshilli Ndërkombëtar i Gjuhës Shqipe, me studiuesit më të mirë të gjuhës dhe i pasuruar me anëtarë të rinj nga akademitë e Shqipërisë dhe Kosovës, nga Qendra e Studimeve Albanologjike, universitetet, si dhe nga diaspora, për përditësimin e plotësimin me hapa të shpejtë të gjuhës shqipe, të detyrimit madhor të shoqërisë shqiptare brenda vendit e në mbarë botën.

Të tilla komisione do të ngrihen hap pas hapi edhe për fushat të tjera, me synimin që ato të jenë shumëdisiplinore: për fushën e historisë, trashëgimisë kulturore, sociologjisë, ekonomisë, financës, problemeve demografike, arsimin, ujit, pyjeve, energjisë, emergjencave civile, bujqësisë dhe ushqimit, biodiversitetit, cilësisë së jetës, bioetikës, mjedisit, etj. Këto komisione do të udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë të fushave, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda e jashtë vendit.

Përrurimi i ngjarjeve të mëdha dhe i figurave më të shquara të kombit, i vlerësimit edhe i figurave të sotme, të cilat analizohen me hollësi në raport, për secilin nga seksionet, ka qenë një tjetër objektiv, me qëllim kryesor trashëgiminë e vlerave tek brezi i ri i kërkuesve e tek shoqëria në përgjithësi, duke vënë në dukje vlerat pozitive të shkencës shqiptare në vite, të cilat nuk janë të pakta në historinë

e zhvillimit të vendit e më gjerë, në botë. Këto veprimtari janë zhvilluar nëpërmjet programit “Edukim në Shkencë”.

Rritja e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, realizimi i marrëveshjeve e protokolleve me institucione kërkimore shkencore e universitare dhe paraqitja e denjë e AShSh-së në takime ndërkombëtare, kanë qenë në fokus të veprimtarisë së saj. Duhet përmendur këtu edhe një sërë takimesh e kontaktesh me studiues e personalitete të kërkimit shkencor, ku është diskutuar për çështje me interes reciprok dhe janë finalizuar marrëveshje, të cilat trajtohen sipas njësive përkatëse.

Përpjekje të konsiderueshme janë bërë në drejtim të pjesëmarrjes së Akademisë së Shkencave në Programet Kuadër të BE-së, apo në programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia në bashkëpunim të ngushtë me AKTI-in, përfaqësohet dhe jep kontribut në nivel ekspertësh në disa nga programet më të rëndësishme (Programet Kuadër) si Transporti dhe Aeronautika, Teknologjitë e Informacionit, Siguria, Bioteknologjia dhe Ushqimi, Shëndeti, Kërkimi dhe Teknologjitë etj.; në pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e AKTI-t, ajo mbulon disa ekspertiza fushash të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim e informacioneve, të cilat bëhen publike nëpërmjet shkrimeve, raporteve, workshop-eve e leksioneve të ndryshme. Nga ana tjetër, jepen mendime në kohë reale edhe për problematika të MASH-it dhe AKTI-it.

Janë realizuar treguesit e buxhetit të vitit 2012 dhe për vitet në vazhdim; projekte për një veprimtari ambicioze kërkimore-shkencore janë parashikuar në projekt-buxhet, sipas një formati të kërkuar së fundmi nga Qeveria. Projekt-buxheti për vitin 2012 është përgatitur nga kryesitë e seksioneve, Njësia e Projekteve, Dega e Financës dhe i gjithë stafi i institucionit, në përputhje me të gjitha udhëzimet e Ministrisë së Financave (me ekspertë të buxhetimit), i miratuar në Këshillin Ekzekutiv të AShSh-së. Me Buxhetin e miratuar për AShSh-në për vitin 2012, me ndihmesën e dashamirësve të AShSh-së, u bë i mundur realizimi me sukses i të gjitha veprimtarive e botimeve të parashikuara, sidomos në 100-vjetorin jubilar të Pavarësisë së Shqipërisë dhe 40-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Edhe gjatë vitit 2012, një rëndësi të veçantë patën veprimtaritë që lidheshin me marrëdhëniet e AShSh-së në planin ndërkombëtar. Akademia e Shkencave bashkëpunoi me institucionet homologe e më gjerë, si me Federatën Europiane të Akademive Kombëtare të Shkencave (All European Academies of Sciences -

ALLEA), Inter Panelin e Akademive (InterAcademyPannel, a Global Network of Sciences Academies - IAP), Rrjetin e Akademive të Vendeve të Botës së Tretë (TWAS), si dhe organizmat shkencorë CNR-Itali, ato të Kombeve të Bashkuara etj. Do të vazhdojë puna për zbatimin e Marrëveshjes së AShSh-së me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë e të shumë veprimtarive të tjera në rajon, duke patur si objektiv të veçantë bashkëpunimin me jashtë në ndihmë të lidhjeve, njohjes e integritit të Shqipërisë në bashkësinë europiane e forcimit të lidhjeve të saj në botë, nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimeve në fusha të kërkimit shkencor në shkencat shoqërore e natyrore-teknike.

Gjatë vitit 2012, AShSh ka realizuar disa veprimtari të rëndësishme në nivel botëror dhe europian:

- përfaqësimin aktiv në Këshillin Ndërkombëtar të Shkencës ICSU me qendër në Paris;
- në organizatën AIESEE-së, duke qenë edhe kryetare e saj e radhës;
- anëtare në UEAA (Union of European Agrarian Academies);
- anëtare në Unionin e Akademive të Danubit, etj.

PJESA E DYTË

VEPRIMTARITË E SEKSIONEVE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Akademia e Shkencave e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2012 ka vazhduar të kryejë veprimtari të ndryshme të kërkimit e zhvillimit me kontribute të ndjeshme në: zhvillimin e vendit në përgjithësi, në drejtim të kërkimit shkencor, arsimit të lartë, të zhvillimit e demokratizimit të shoqërisë, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimeve teknologjike e inovative të biodiversitetit e biologjisë, informacionit, shëndetit e rritjes së cilësisë së jetës, të ekonomisë e biznesit etj. Këto veprimtari janë zhvilluar nëpërmjet projekteve, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare (brenda e jashtë vendit), botimeve të monografive, revistave

periodike shkencore, udhëzuesve, botimeve të veçanta e atyre për publikun e gjerë, mësimdhënies në nivelet e ndryshme të arsimit të lartë e të kualifikimit shkencor, përmes takimeve publike, pranisë në median e shkruar e atë televizive, në pjesëmarrjen me ekspertiza e konsulenca, në hartimin e programeve në nivele të ndryshme institucionale etj.

Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike. Në përputhje me orientimin themelor të studimeve në fushë të shkencave shoqërore dhe albanologjike për ndriçimin e vlerave identitare të kombit, të traditave historike, gjuhës e kulturës së tij materiale dhe shpirtërore, gjatë vitit 2012 , vit i 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në bazë të një pune të gjerë të programuar, kërkimet, studimet dhe botimet shkencore u orientuan nën shenjë e këtij përvjetori dhe u konkretizuan me një sërë rezultatesh e veprimtarish shkencore të realizuara me sukses edhe në kushtet e mungesës së fondeve.

Veprimtaria qendrore shkencore e organizuar nga Akademia e Shkencave ishte *Akademia Solemne*, kushtuar 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, mbajtur në Tiranë më 26 nëntor 2012. Kjo akademi u konceptua si një forum i lartë shkencor, me pjesëmarrjen e disa prej studiuesve më të shquar, personalitete të njohura në këtë fushë studimesh nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, bota arbëreshe, albanologë të njohur nga jashtë, Nikolla Pano e Bernd Fisher nga ShBA, Titos Johalas nga Greqia, Mihail Shmidt Neke nga Gjermania, Francesko Altimari nga Italia, Hivzi Islami nga Kosova dhe Mirie Rushani nga Maqedonia.

Referatet e mbajtura në këtë veprimtari dallohen për nivelin e lartë shkencor të trajtimit dhe interpretimit historik të fakteve dhe proceseve që çuan në shpalljen e Shtetit të Pavarur Shqiptar dhe nga prirja përgjithësuese; ato ishin model i një sinteze historike që kapërcen dhe tejkalon deskriptivizmin, si një sëmundje prej së cilës kanë vuajtur dhe vuajnë shpesh studimet historiografike. Kumbtimet, me objektivitetin shkencor të trajtimit të fakteve, ishin dhe një përpjekje e re për të kapërcyer si frymën panegjirike, ashtu edhe njëanshmërinë që manifestojnë shpesh këto studime nën trysninë e parapëlqimeve ideologjike ose konjunkturave politike.

Mbi bazën e një analize objektive të fakteve dhe dokumentacionit historik të kohës, referatet e mbajtura në konferencë konfirmuan disa përfundime për thelbin, përmbajtjen dhe karakterin, jo vetëm të aktit të Shpalljes së Pavarësisë, por dhe të epokës së re që shënoi ai akt; konfirmuan faktin se Shpallja e Pavarësisë ishte

produkt i lëvizjes kombëtare shqiptare dhe jo dhuratë e Fuqive të Mëdha, si një projekt i pjekur në mendimin e rretheve të emancipuara të botës shqiptare që nga gjysma e dytë e shekullit XIX, si një vizion i elitës së kombit veçanërisht pas Lidhjes së Prizrenit, se produkt i "koncertit europian" nuk ishte Shqipëria e pavarur, por principata jetëshkurtër e Vidit. Gjithashtu, konferenca hodhi dritë në rëndësinë historike epokale të vendimeve që mori Kongresi Kombëtar i Vlorës më 28 nëntor 1912, të cilat sanksionuan politikisht dhe juridikisht ideologjinë iluministe të Rilindjes Kombëtare, orientimin e ndërgjegjes politike dhe shoqërore të kombit drejt qytetërimit europian dhe për një shtet laik e modern të tipit perëndimor, duke veçuar në këtë mes rolin e Ismail Qemalit, si arkitekt i Pavarësisë dhe themelues i shtetit të parë modern shqiptar.

Aktet e *Akademisë Solemne* do të botohen në një vëllim më vete dhe së bashku me "**Albumin**" për Ismail Qemalin, me monografinë "**Lidhja Shqiptare e Prizrenit**", përgatitur nga **Akad. Kristo Frashëri**, monografinë "**Popullsia e Kosovës në vitet 1831-1912**", përgatitur nga **Akad. Kristaq Prifti** dhe ribotimin e përpunuar në anglisht, të librit "**Studime për Prehistorinë e Shqipërisë**", përgatitur nga **Akad. Muzafer Korkuti**, përbëjnë korpusin e veprave albanologjike të botuara në këtë rast nga Akademia, të financuara nga subjekte private.

Gjatë vitit 2012, anëtarët e Seksionit të ShShA kanë realizuar:

- 20 projekte shkencore (3 kombëtare dhe 17 ndërkombëtare);
- 11 konferenca shkencore (2 ndërkombëtare dhe 9 kombëtare);
- 19 monografi;
- 20 botime në revista shkencore (9 brenda dhe 11 jashtë vendit);
- 27 aktivitete të tjera botuese;
- 80 artikuj popullarizues;
- 85 pjesëmarrje në konferenca shkencore (48 brenda dhe 37 jashtë vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë "Akademikëve" dhe "Akademikëve të asociuar" të Seksionit të AShSh-së (gjithsej 19) si dhe 4 prej "Akademikëve" mbi moshën 75 vjeç.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike edhe për vitin 2012, ka vijuar të ketë përparësi të tij veprimtari të orientuara në përputhje me Strategjinë

Kombëtare të Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacionit dhe të studimeve të orientuara qeveritare në fusha të tilla si: rregullimi i regjimit ujor në liqene, shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme (gjeotermale, nga biomasa etj.) dhe aplikimeve praktike me projekte pilote, me synim ngritjen e NMV-ve në Shqipëri; teknologjitë e informimit e komunikimit; shëndetësia dhe shërbimi parësor; vlerësimi, ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve natyrore, pyjeve dhe problematikat e menaxhimit të tyre; biodiversiteti dhe cilësia e ushqimit; transferimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në fusha të ndryshme e me përparësi si ato të trashëgimisë kulturore; të E-sistemeve e të teknologjive të informacionit; studimet e teknologjive të reja për identifikimin e monitorimin e mjedisit; studimet bujqësore e pastorale, vreshtaria etj.; fusha e emergjencave civile e sigurisë etj.

Këto veprimtari janë zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe të Malit të Zi, Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim të AKTI-t, ato të Qeverisë, si dhe nëpërmjet punës individuale të akademikëve në sektorët ku punojnë, të cilat janë realizuar nëpërmjet projekteve, konferencave, workshop-eve, konsultave kombëtare e ndërkombëtare. Këto veprimtari jepen hollësisht në rubrikat e mëposhtme.

Gjatë vitit 2012, anëtarët e Seksionit të ShNT kanë realizuar:

- *36 projekte shkencore*, nga të cilat: një projekt i nomenklaturës qeveritare (Këshillit të Ministrave); 4 projekte në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim – AKTI; 1 projekt nga Protokollet dypalëshe ndërmjet MASH dhe homologëve të tyre; 6 projekte nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe 1 me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë; 24 projekte në kuadër të programeve të BE-së (FP-7 dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë);

- *5 konferenca shkencore* (1 ndërkombëtare dhe 4 kombëtare);

- *12 monografi* (8 brenda dhe 4 jashtë vendit);

- *82 botime në revista shkencore* (16 brenda dhe 66 jashtë vendit);

- *8 aktivitete të tjera botuese*;

- *47 artikuj popullarizues*;

- 69 pjesëmarrje në konferenca shkencore (34 brenda dhe 35 jashtë vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë "Akademikëve" dhe "Akademikëve të asociuar" të Seksionit të ShNT (gjithsej 22) si dhe 1 prej akademikëve mbi moshën 75 vjeç.

Më poshtë po paraqesim sipas rubrikave të veçanta veprimtaritë kërkimore shkencore dhe botuese të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të Akademisë së Shkencave.

PROJEKTE

Me fillimin e veprimtarisë, edhe Akademia e Shkencave nëpërmjet anëtarëve të saj u përfshi institucionalisht apo si bashkautore në projektet e programeve të ndryshme të PKKZH-së që menaxhohen nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacioneve (AKTI). Nga ana tjetër, akademikët kanë marrë pjesë edhe në projekte në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI), duke qenë pjesë aktive e komunitetit shkencor në universitete e në institucione shkencore, pranë universiteteve e jashtë tyre me kontribut në ideimin, koordinimin e menaxhimin e projekteve të rëndësishme për zhvillim.

Sipas seksioneve, projektet e zhvilluara gjatë vitit 2012, renditen si më poshtë:

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Gjatë vitit 2012 ka vazhduar puna mbi disa projekte të parashikuara në planet afatshkurtra dhe afatgjata të Seksionit.

C. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2011-2013), nënshkruar nga kryetarët e të dy akademive, ku përfshihen projektet e mëposhtme:

1. Projekti ***Mbi veprimtarinë e Këshillit Ndërademik për Gjuhën Shqipe (2012)***. Ky projekt parashikon punën e bashkërenduar midis dy institucioneve, përmes këtij organizmi, për standardin e shqipes dhe standardizimin e

terminologjisë tekniko-shkencore. Puna për këtë projekt është në vazhdim. Pas një ndërprerjeje për shkaqe objektive të reformimit dhe mungesës së fondeve, gjatë vitit 2012 rifilloi puna e Këshillit Ndërkademi, e riorganizuar edhe me krijimin e Kryesisë së Këshillit Ndërkademi si organizëm jo vendimmarrës shkencor, por me synim bashkërendimin e punës brenda Këshillit dhe me institucionet e tjera të përfshira në projekt, veçanërisht me Qendrën e Studimeve Albanologjike. Gjatë këtij viti, Këshilli Ndërkademi ka zhvilluar dy mbledhje pune për çështje të veçanta të standardit, në pamundësi të mbledhjes më shpesh për mungesë të mjeteve financiare.

2. Botimi, *Studime arkeologjike në Kosovë (2012)*. Vepër e përbashkët e të dy akademike shqiptare. Ky studim synon të njëjtat qëllime profesionale me ato të parashikuara; kështu në thelb nuk kemi të bëjmë me ndryshime të përfillshme të veprës së parashikuar me atë paralelen, tashmë të përfunduar dhe dorëzuar prej palës së AShSh, organizmit botues AShAK.

3. *Ekspeditë etnografike në kuadër të projektit Ndërmjet tradicionales dhe bashkëkohores - Jeta e përditshme dhe arti popullor në Kosovë (2012)*. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet AShSh dhe AShAK, me mbështetje të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë janë kryer dy ekspedita kërkimore në terren (nga pala shqiptare Prof. dr. Afërdita Onuzi). Ekspeditat janë kryer kryesisht në fshatra të ndryshme të Kosovës, me objekte muzeale të qyteteve Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Prishtinë. Ky projekt do të finalizohet me botimin e albumit ***Art Popullor në Kosovë***, i cili do të përmbajë art popullor nga qendrat qytetare dhe fshatare, kryesisht tekstile popullore (lesh, mëndafsh, pambuk), qëndisje fshatare dhe qytetare, argjendari (stoli grash e burrash, pajisje shtëpiake etj.), punime në dru, punime në bakër etj. Objektet i përkasin kryesisht fillimit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Albumi shoqërohet dhe me një parathënie studimore në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Ç. Projekte të mbështetura nga akademitë e shkencave dhe organizma europianë apo ndërkombëtarë

1. *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, projekt i drejtuar nga **Akad. i asoc. Malenglen Verli** dhe i finalizuar në 2012-ën, me botimin e 7 vëllimeve me dokumente të Austro- Hungarisë.

2. Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913), projekt i drejtuar nga **Akad. i asoc. Malenglen Verli** dhe i finalizuar në 2012-ën, me botimin e 6 vëllimeve me dokumente të Austro- Hungarisë.

3. Qeverisja dhe zhvillimi Territorial, projekt i Universitetit të Studimeve të Palermos, Itali, Universiteti "Zonja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Instituti i Formimit Politik Pedro Arupe, Palermo, Itali dhe Organizata Magis, zhvilluar në Tiranë (2011-2012). **Akad. i asoc. Aurela Anastasi** është anëtare e Komitetit Koordinues dhe pedagoge e lëndës "Sistemi Normativ në Republikën e Shqipërisë", në masterin pasuniversitar të Nivelit të Dytë. Si produkt shkencor i këtij projekti u hartua në gjuhën italiane programi i ri i studimit "Sistemi Narrativ në Republikën e Shqipërisë", u krijua fushë e re studimi, u hartuan leksione në gjuhën shqipe. Ky projekt, zhvillohet për herë të parë në të gjitha ciklet e studimit universitar.

4. Përgatitja e kërkesë-padive strategjike në lidhje me respektimin e parimit të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, ekspertizë për realizmin e projektit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen dhe partneritetin e UNDP, Tiranë (2012-2013). Drejtore ekzekutive e këtij projekti është **Akad. e asoc. Aurela Anastasi**. Do të hartohet buletini me vendime të Komitetit të CEDAW dhe gjykatave ndërkombëtare, si dhe komente për çështje të zbatimit të parimit të barazisë gjinore. Gjithashtu do të botohet raporti i monitorimit të gjykatave në lidhje me respektimin e parimit të barazisë gjinore. Do të përgatiten dhe do të përfaqësohen në gjykata kërkesëpadi strategjike.

5. Për monitorimin e gjykatave të shkallës së parë, për një proces të rregullt ligjor, në luftë kundër korrupsionit, ekspertizë për realizmin e Projektit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen e USAID, Tiranë (2012-2014). Drejtore ekzekutive e projektit, **Akad. e asoc. Aurela Anastasi**. Si produkt i këtij projekti, do të përgatitet raporti i monitorimit të gjykatave për një proces të rregullt ligjor.

6. Atlasi linguistik i Europës, projekt ndërkombëtar në shkallë europiane, i cili ka filluar punën prej vjetësh dhe vazhdon punimet sipas një plani shumëvjeçar, në mbledhje vjetore me kryerje të punëve për redaktimin e botimit e hartave të ALE-së. Komiteti shqiptar, i përbërë nga **Akad. i asoc. Gjovalin Shkurtaaj, Akad. Kolec Topalli, Prof. dr. Enver Hysa dhe Prof. dr. Seit Mansaku**, ka detyrimin që për çdo vit të marrë pjesë dhe të japë kontributin e caktuar në punimin e hartave të

Atlasit. Akad. i asoc. Gjovalin Shkurtaj dhe Akad. Kolec Topalli morën pjesë në mbledhjen e radhës, që u mbajt në Riga (Letoni), 27 deri 30 maj 2012, me referimet e tyre për hartat e parashikuara dhe diskutimet për hartën me titull "*dance*". Në këtë projekt ndërkombëtar me rëndësi edhe për gjuhësinë shqiptare, puna e anëtarëve të Komitetit shqiptar është vlerësuar si ndihmesë serioze nga presidenti i ALE-së, Nicolae Saramandu.

7. *Filozofia racionaliste europiane e shek. XX.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

8. *Mediet audiovizive publike në Shqipëri dhe reformimi i tyre.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

9. *Komunikimi në institucionet e ndëshkimit në Shqipëri.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

10. *Propaganda në regjimet autoritare.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

11. *Interneti dhe impakti i tij mbi komunikimin masiv në Shqipëri.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

12. *Strategjitë e marketingut në sistemin bankar shqiptar.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

13. *Mediet dhe besimet fetare në opinionin publik shqiptar.* Akad. Artan Fuga, drejtues shkencor i projektit në kuadër të përgatitjes së doktoraturave në shkenca të komunikimit dhe filozofi, Universiteti i Tiranës.

14. *SeeNet*, projekt shkencor i financuar nga Regione Emilia-Romagna, Itali. Në këtë projekt, **Akad. i asoc. Kosta Barjaba** ka qenë konsulent për reformimin e sistemit të shërbimeve sociale në Shqipëri.

15. *PAYOKA*, projekt i financuar nga Bashkimi Europian, **Akad. i asoc. Kosta Barjaba** ka marrë pjesë si konsulent për sinergjinë midis kanaleve migratore dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

16. Transnational networks, Transnational entrepreneurship and role of the state, financuar nga Kooperacioni Zviceran; konsulent për *Literature Review* dhe punë në fushë në Shqipëri, **Akad. i asoc. Kosta Barjaba**.

17. Forumi Albanosfera, financuar nga Fondacioni “Fridrich Ebert”; konsulent për diasporat shqiptare në rajon, **Akad. i asoc. Kosta Barjaba**.

Ecuria e projekteve për këtë seksion paraqitet si më poshtë:




Fig. 6. Projektet e seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike

II. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

A. Projekte të nomenklaturës qeveritare (Këshillit të Ministrave)

Projekt Qeveritar - Strategjia Kombëtare e Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe e Inovacionit (2016-2020), Y. Pango, E. Late, **Akad. S. Bushati**, E. Pustina, E. Agolli, A. Shahini & M. Bimo (Grup pune për përgatitjen e draft-strategjisë, MASH, Tetor 2012);

Në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacionit për periudhën 2016-2020, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë u ngrit një grup me ekspertë nga fusha e arsimit dhe shkencës, për përgatitjen e draft-strategjisë e cila ka përfunduar dhe është në procesin e vlerësimit nga Këshilli i Arsimit Lartë dhe Shkencës, si dhe institucionet e sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës.

B. Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH–AKTI), Protokolle të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI) dhe programe të tjera (Cilësi dhe Barazi në Arsim, BB dhe MASH).

Në veprimtaritë me projekte, anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike kanë vazhduar veprimtarinë e tyre shkencore në programe të ndryshme të PKKZH-së, që drejtohen nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacioneve (AKTI), me kontribut si koordinatorë, bashkëpunëtorë apo këshilltarë edhe në projekte në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI). Këto veprimtari realizohen duke qenë pjesë aktive e komunitetit shkencor në universitete e në institucione shkencore pranë universiteteve e jashtë tyre. Marrëveshjet e Bashkëpunimit Shkencor të Akademisë së Shkencave me universitetet më në zë në vend, kanë krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e këtyre veprimtarive me rëndësi të veçantë.

Numri i projekteve për kërkimi e zhvillim ka qenë në parametra të mirë dhe në rritje, në krahasim me vitin 2011. Akademikët kanë dhënë kontribut edhe gjatë 2012-ës me pjesëmarrjen aktive të tyre në grupet e ekspertizave për përzgjedhjen e projekt-propozimeve, vlerësimin afat-mesëm të ecurisë e të raporteve të projekteve të PKKZH-së, si dhe në forume të ndryshme, në promovime të programeve të ndryshme europiane etj.

Projektet e zhvilluara gjatë vitit 2012 në fushat e shkencave natyrore e teknike renditen më poshtë.

PROGRAME KOMBËTARE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (PKKZH AKTI)

1. “Aplikimi i Teknologjisë së Imazheve Radar (PSIn SAR) në vlerësimin dhe parashikimin e integruar të fenomeneve gjeodinamike me qëllim zbutjen e pasojave në zonat urbane dhe turistike të rajonit Durrës-Kavajë”, Projekt i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh) dhe i Akademisë së Shkencave, me drejtues shkencorë Dr. M. Lamaj, A. Avxhiu, L. Moisiu, M. Dardha, M. Josufati (ShGjSh) dhe bashkëpunëtorë **Akad. S. Bushati** dhe **Akad. N. Frashëri**. Projekti

financohet nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim "Biodiversiteti dhe Mjedi" 2010-2013.

Projekti synon eksperimentimin e përdorimit të imazheve satelitore, në veçanti të tipit radar (SAR ~ Synthetic Aperture Radar), për studimin e rrëshqitjeve të tokës në zonën Durrës-Kavajë dhe të dinamikës së vijës bregdetare në zonën e Semanit dhe të Patokut.

Grupi i Akademisë së Shkencave ka si objektiv studimin e dinamikës së vijës bregdetare. Gjatë studimeve të kryera në periudhën 2010 – 2012 janë marrë rezultatet të shumta në drejtim të kësaj teknologjie të re, duke krahasuar imazhet satelitore me situatën gjeologjike (rrëshqitjet) në terren. Megjithatë, përfundimi i projektit më 2012, u vështirësua nga mungesa e fondit të caktuar për blerjen e imazheve SAR. Në këto kushte, u punua me imazhet e LANDSAT, si dhe u bënë vërtetime në terren. Nga analiza e imazheve u identifikuan ndryshime të panjohura më parë të bregdetit në zonën e Semanit, si rezultat i lëvizjeve të deltave të lumenjve në këtë zonë. Mbetet që në vitin 2013, me mundësitë financiare të AKTI-t të blihen imazhet e duhura satelitore për verifikimin e rrëshqitjeve dhe ndërtimin gjeologjik në rajonet e studiuara.

2. "Vlerësimi i parametrave dhe fenomeneve të ndotësve të ajrit dhe impaktet në mjedis", me drejtues shkencor **Akad. F. Vila**, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), "Biodiversiteti dhe Mjedi" 2010-2012. Institucioni kontraktues është FSHN UT, në të cilin janë angazhuar Departamenti i Fizikës, Departamenti i Teknologjisë Kimike dhe Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, ndërsa institucionet që bashkëpunojnë janë Fakulteti i Shkencave Natyrore i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër (Departamenti i Fizikës, Kimisë dhe i Biologji – Kimisë), si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe e Mjedisit.

Gjatë vitit 2012 janë kryer matje eksperimentale për vlerësimin e përqendrimit të grimcave aerosole (përqendrime numerike dhe në masë); të joneve atmosferike, të gazit të radonit, si dhe janë kryer regjistrime të parametrave atmosferikë. Matjet janë realizuar përgjithësisht në lartësi të ulëta, rreth 1-2 m; megjithatë, për të studiuar profilet vertikale të grimcave aerosole dhe të joneve atmosferike, janë realizuar matje deri në lartësinë 30 m nga sipërfaqja e tokës.

Në të gjitha fushatat e matjeve janë vlerësuar parametrat meteorologjikë, si temperatura e ajrit, lagështia relative, presioni atmosferik, shpejtësia, drejtimi dhe shtjellat e erës, rrezatimi diellor, etj. Banda e kuotave të pikave ku janë realizuar

matjet eksperimentale varion nga niveli i detit (zonat bregdetare), deri në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit (zonat malore).

Harta e pikave të monitorimeve përfshin shumë zona të Shqipërisë, nga Shkodra në veri, deri në Vlorë në jug. Në to janë përfshirë zona urbane e rurale, ultësira fushore, zona kodrinore, zona malore, zona pranë buzë lumenjve dhe liqeneve si dhe zona bregdetare.

Monitorimet e përqendrimeve të joneve atmosferike janë realizuar në zonën urbane e të rrethinave, si dhe në zonat rurale, malore, liqenore e bregdetare të rajonit të Shkodrës. Vlerat mesatare më të larta të përqendrimit të joneve të ajrit janë hasur në zonat malore, duke dhënë një tregues të cilësisë së ajrit në këto zona. Vlera të përafërta me to kanë edhe zonat rurale, të karakterizuara nga një shkallë e lartë e pastërtisë së ajrit. Një tregues tjetër i cilësisë së ajrit është edhe faktori i unipolaritetit, i barabartë me raportin e përqendrimeve të joneve pozitive me ato negative. Matjet eksperimentale tregojnë se cilësinë më të mirë të ajrit e ka zona bregdetare dhe ajo malore, ku faktori i unipolaritetit është më i vogël se 1.5, ndërsa cilësinë më të ulët e kanë zonat urbane, të rrethinave dhe të qendrës, ku faktori i unipolaritetit është më i madh se 2.

Monitorimet e përqendrimeve numerike të grimcave aerosole, janë realizuar kryesisht në zonat ku janë kryer edhe matjet e joneve atmosferike, duke i ndarë kryesisht në tri lloje kryesore: *fine* (0.3-0.5 μm), *mikse* (0.5-5 μm) dhe *të trasha* (5.0-100 μm). Rezultatet eksperimentale tregojnë se për grimcat fine, vlerat minimale arrihen në zonën malore dhe maksimalet në zonën bregdetare, sidomos gjatë sezonit të vjeshtës. Për grimcat e trasha, vlerat minimale hasen në zonat malore, rurale, liqenore dhe të rrethinave dhe vlerat maksimale në zonën urbane dhe sidomos në nënzonën trotuare, ku tejkalohet mesatarja e përgjithshme rreth tri herë. Vlerat minimale për llojin *mikse*, janë hasur përsëri në zonën malore, ndërsa vlerat maksimale në zonën urbane.

Studimet për evidentimin e faktorëve të ndryshëm në përqendrimin numerik të grimcave aerosole na çojnë në përfundimin se:

- Në zonën urbane, faktorët kryesorë ndikues janë emetimet nga trafiku, sidomos për grimcat fine, emetimet nga aktivitetet e banesave dhe tregtare për llojet fine dhe mikse, pluhurat dhe risuspensionin e shkaktuar nga era dhe lëvizja e automjeteve dhe aktivitetet e ndërtimit për grimcat e trasha, si dhe djegia e

biomasës (djegia e mbeturinave të qytetit në periferi të tij) për grimcat fine dhe mikse;

- Në zonën e rrethinave ndikojnë pothuajse të njëjtët faktorë, por me intensitet më të ulët;
- Në zonat rurale ka ndikim të vogël të trafikut, të aktiviteteve të banesave, si dhe ndihet dukshëm efekti i proceseve të djegies së biomasës nëpër fusha;
- Në zonat malore të gjithë faktorët ndikojnë në një nivel minimal;
- Në zonat liqenore janë të dukshëm efektet emetuese dhe risuspensionit i trafikut në aksin kryesor të qytetit, aktivitetet tregtare në pjesën turistike jugperëndimore të liqenit të Shkodrës, dhe djegia e biomasës në pjesën verilindore të liqenit;
- Zona bregdetare ka ndikim të dukshëm të trafikut (emetues dhe risuspension), të aktiviteteve të banesave, tregtare dhe të ndërtimit gjatë sezonit turistik të verës, si dhe djegiet e biomasës gjatë gjithë vitit. Për këto zona një ndikues shumë i ndjeshëm, sidomos për grimcat fine, janë edhe kripërat.

3. “Ngritja e një qendre laboratorike studimore të shfrytëzimit të biomasës agropjore për biogaz dhe energji, si dhe analiza e strukturës inxhinierike të proceseve në një impiant pilot eksperimental”, me drejtues shkencor **Akad. i asoc. I. Malollari**, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), “Biodiversiteti dhe Mjedisi” 2010-2012.

Projekti është në vitin e tretë të tij dhe përveç kompletimit të skemës së eksperimentimit, ka vazhduar puna për trajtimin e modelit matematik të procesit dhe për gjetjen e mënyrës më të përshtatshme për vlerësimin ekonomik të sipërmarrjes me përdorim të teknologjive alternative të trajtimit të biomasës agropjore. Është plotësuar më shumë laboratorit ekzaminues me pajisje të tilla si HPLC, GC FID, Thermocycler, etc.

4. “Metalet nanostrukturore të prodhuara nëpërmjet deformimit të fortë plastik”, me drejtuese **Akad. e asoc. A. Veveçka**, në kuadrin e Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim (PKKZH), “Biodiversiteti dhe Mjedisi” 2010-2012.

Gjatë vitit 2012, projekti nuk ka realizuar objektivat e pritshme për arsye të mungesës së fondeve nga AKTI, të parashikuara në aprovimin e projektit.

PROTOKOLLE TË BASHKËPUNIMIT SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK DYPALËSH

1. ***“Karakterizimi (kimik, fizik, ekotoksikologjik) dhe analiza; rreziku ekologjik i biocideve antivegetative në jug të detit Adriatik - CARISMA”*** (Caratterizzazione chimico, fisica, ecotossicologica ed Analisi; Rischio ecologico di biocidi antivegetativi nel sud del mare Adriatico - CARISMA), në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Dypalësh Itali – Shqipëri, me drejtues Prof. dr. A. Tabaku, Prof. dr. P. Laze, Dr. P. Aleks, **Akad. S. Bushati** dhe Agenzia Nazionale per le nuove tecnologie, l’energia e sviluppo economico sostenibile (ENEA) Ambiente ed energia: Biocidi Antivegetativi; Ecotossicologia, Ecological Risk Assessment, me partnerë Unita’ Tecnica Tecnologie Portici, Laboratorio Chimica Ambientale, Napoli, Italia; **Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i AShSh**; Fakulteti i Shkencave të Natyrës; Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe i Veterinarisë.

Synimi i projektit është vlerësimi ekotoksikologjik i biocideve, si dhe i rrezikut të tyre në mjedise ujore si pasojë e teknologjive që përdoren në peshkim.

Gjatë vitit 2012 janë përcaktuar zonat e marrjes së kampionëve të ujit, të sedimentit dhe të gjallesave ujore në disa porte të vendit tonë (Shëngjin, Durrës dhe Vlorë) dhe mostrat e marra, pas trajtimit paraprak në laboratorët shqiptarë, janë dërguar për analiza të mëtejshme në laboratorët bashkëpunëtorë në Itali.

C. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademive të Shkencave dhe të Arteve të vendeve fqinje

Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2011-2013), nënshkruar nga Kryetarët e të dy Akademive, brenda së cilës përfshihen projektet e mëposhtme:

1. ***Fjalor shpjegues i termave të botanikës.*** Hartimi dhe botimi i fjalorit me koordinatore **Akad. J. Vangjeli**, (AShSh) dhe **Akad. F. Krasniqi** (AShAK) me bashkëpunëtorë **Akad. e asoc. E. Kongjika** (AShSh) dhe **Akad. L. Susuri** (AShAK).

Ky projekt përfundoi me hartimin dhe botimin e fjalorit, i cili u përrua në dhjetor 2012. Një ndihmesë të veçantë në përgatitjen e fjalorit në formën e duhur gjuhësore për lexuesit ka dhënë redaktori, Prof. dr. A. Duro. Kjo vepër është në vazhdë të botimit të dy fjalorëve të tjerë, *Fjalori i emrave të bimëve* (2003) dhe *Fjalori i Terminologjisë së Botanikës* (2006), me grupe autorësh nga të dy akademitë.

Synimi i projektit ka qenë grumbullimi i pasurisë gjuhësore në fushën e terminologjisë së shkencës së botanikës dhe përfaqëson përpjekjen e parë për hartimin e një fjalori shpjegues kaq të gjerë, me rreth 11000 terma dhe 1000 skica. Botimi i ri plotëson një nevojë të kohës për biologët për t'u njohur me përparimet në fusha tradicionale themelore, si morfologjia, anatomia, fiziologjia, gjenetika, por dhe në ato relativisht më të reja si ekologjia, fitosociologjia, biodiversiteti, biologjia molekulare, bioteknologjia si dhe në fusha të shkencave më të aplikuara si pylltaria, fitopatologjia, hortikultura etj.

Një botim i tillë do të gjejë vend në bibliotekat e studiuesve dhe studentëve të institucioneve mësimore dhe shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Ky fjalor do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm drejt shqipërimin dhe njësimit të termave të kësaj shkence dhe degëve të shumta të saj, duke zëvendësuar në mjaft raste terma të huaj të përdorur në punimet apo tekstet e kësaj fushe.

2. Projekti “Klima dhe parametrat projektues për sistemet HVAC për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”, që zhvillohet nën kujdesin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me koordinatore Dr. Ramadan Alushaj (AShSh; DE, FIM, UPT) dhe Akad. korrespondent Fejzullah Krasniqi (AShAK, Instituti Hidrometeorologjik, Kosovë), si dhe me bashkëpunëtorë Prof. i asoc. Vangjel Mustaqi dhe Prof. dr. Marenglen Gjonaj (AShSh, INGjEUM) (2011 e në vazhdim).

Objektivat ku është përqendruar projekti për vitin 2012, sipas kontakteve midis dy grupeve, janë:

(i) Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave mbi parametrat kryesorë të klimës për qytetet e Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë, siç janë: temperatura e ajrit të lagësht, lagështia e ajrit, presioni, intensiteti i rrezatimit diellor etj.;

(ii) Ndërtimi i metodës së përcaktimit dhe realizimit të vlerave të kushteve të jashtme projektuese për sistemet HVAC;

(iii) Përcaktimi i metodës së njehsimit të ngarkesës ngrohëse për dimër dhe të ngarkesës ftohëse për verë për qytetet e lartpërmendura.

Për realizimin e këtyre problematikave të projektit nga stafi, për pjesën e Shqipërisë janë realizuar:

1. Grumbullimi i të dhënave mbi parametrat kryesorë të klimës për qytetet kryesore – i cili është në proces;

2. Ndërtimi i metodës së përcaktimit dhe realizimit të vlerave të kushteve të jashtme projektuese për sistemet HVAC – për të cilën është përpunuar metodika e realizimit të këtyre kushteve projektuese klimatike.

Janë hartuar metodikat e mëposhtme:

1. Përcaktimi i mënyrës së zgjedhjes së muajve për projektimin në verë dhe në dimër, i cili jepet me pasqyra për periudhën nga 10 deri 20 vitet e fundit, për çdo qytet;

2. Analizimi i periudhave gjithëvjetore për vlerat e temperaturave orare për 10-20 vitet e fundit në bazë të përqindjes së riskut të garantimit të temperaturave të jashtme për muajt e verës dhe të dimrit dhe ndërtimi i pasqyrave për çdo qytet me përqindjet e lejuara;

3. Krijimi i pasqyrave të kushteve të jashtme për kushte të caktuara projektimi për ngrohje dhe për ajrin e kondicionuar.

Janë paraqitur tri modelet e pasqyrave të temperaturave që duhen ndërtuar për çdo qytet, në bazë të të dhënave klimatike reale.

Si detyrë e ardhme e afërt mbetet që të dyja palët, në bazë të materialeve të përgatitura, të organizojnë takimin e radhës për të diskutuar për vazhdimësinë dhe realizimin e projektit.

3. Projekti “Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri”; zhvillohet nga AShSh (SSHNT; FSHN-UT; UBT) dhe ASHAK (SShN), me koordinatore të projektit **Akad. e asoc. E. Kongjika** (AShSh) dhe **Akad. L. Susuri** (ASHAK), (2009 e në vazhdim).

Gjatë vitit 2012 janë realizuar dy takime të grupeve përkatëse të punës, në Prishtinë (mars 2012) dhe në Tiranë (maj 2012). Takimet kanë pasur si objektiv fillimin e hartimit të monografisë *Prodhimi dhe çertifikimi i fidanëve të painfektuar*

të drurëve frutorë, hardhisë, ullirit dhe agrumeve, që do të kurorëzojë gjithë punën e realizuar. Një pjesë e bashkautorëve nga pala e Shqipërisë kanë hartuar kapitujt e poshtëshënuar:

- “Pemëtaria (drurët frutorët, ulliri, hardhia dhe agrumet) në Shqipëri dhe Kosovë: rëndësia e kultivarëve të vendit” (R. Osmani);
- “Tradita, aktualiteti dhe perspektiva e prodhimit të fidanëve në Shqipëri dhe Kosovë” (R. Osmani, L. Susaj);
- “Metodat kryesore të prodhimit të fidanëve të drurëve frutorë dhe të hardhisë” (I. Çiçi, H. Ismaili, B. Ferraj);
- “Legjislacioni evropian për prodhimin e fidanëve: kategoritë e fidanëve të çertifikuar dhe CAC: Normativat për drurët frutorë, ullirin, hardhinë dhe agrumet” (A. Myrta, V. Ibro, Sh. Çali);
- “Legjislacioni vendor për prodhimin e fidanëve: kategoritë e fidanëve të çertifikuar dhe CAC: Normativat për drurët frutorë, ullirin, hardhinë dhe agrumet në Shqipëri dhe Kosovë dhe nevojat për përmirësimin e tij” (F. Elezi, H. Ismaili, Sh. Shahini. I. Meta);
- “Seleksionimi i kultivarëve/kloneve të vendit, si bazë për çertifikimin e fidanëve” (F. Elezi, B. Ferraj, H. Ismaili);
- “Metodat e shëndetësimit: Termoterapia dhe Kultura *in vitro* e meristemës” (E. Kongjika, V. Sota, E. Spahiu).

Dorëshkrimet e materialeve të përgatitura i kanë kaluar palës kosovare për hartimin edhe të kapitujve, që i përkasin asaj. Mbetet detyrë hartimi i kapitujve të mbetur dhe hartimi përfundimtar nga moderatorët kryesorë (Akad. L. Susuri, **Akad. e asoc. E. Kongjika**, Prof. dr. A. Zajmi dhe Prof. i asoc. Dr. A. Myrta).

Propozohet që projekti të vazhdojë dhe në Protokollin e ri (2013 – 2015), që do të nënshkruhet midis dy akademive në maj 2013 dhe do të ketë si objektiv botimin e monografisë.

4. Fjalori shpjegues për mjedisin, me koordinatör të palës shqiptare **Akad. Dh. Haxhimihali** (AShSh, SShNT) dhe bashkëpunëtorë **Akad. S. Bushati**, **Akad. e asoc. E. Kongjika**, **Akad. J. Vangjeli**, Prof. dr. Emil Lafe, Prof. dr. N. Peja etj., dhe nga studiuesit kosovarë të AShAK (SGjL).

Objekt i këtij projekti është hartimi dhe dorëzimi për shtyp i një fjalori shpjegues të përditësuar për terminologjinë mjedisore, me më shumë se 4000 terma.

Fjalori do të shënojë një hap të rëndësishëm drejt sistemimit, standardizimit dhe shqipërimit të termave mjedisore, duke sjellë një saktësim në mënyrën sesi përdoren ata aktualisht, si edhe duke sugjeruar në mjaft raste zëvendësimin e termave të huaj të përdorur në punimet apo tekstet e kësaj fushe. Synimi është që të pasqyrohet e të saktësohet pasuria leksikore në fushën e terminologjisë së mjedisit. Fjalori do të jetë në gjuhën shqipe, por termi që çel zërin do të jepet edhe në gjuhën angleze. Ky fjalor do të jetë shumë i dobishëm jo vetëm për specialistët e fushës së gjerë mjedisore, por edhe për publikun e gjerë - sot përdorues të shkencave të lidhura me mjedisin, për studentët dhe mësuesit etj.

Pala kosovare, që në fund të vitit 2011, ka njoftuar se nuk ishte e përgatitur për realizimin e këtij projekti; në këtë situatë pala shqiptare ka vazhduar e vetme punën për realizimin e këtij projekti. Në kushtet e kufizimit të buxhetit, pas një shqyrtimi është bërë një skicim paraprak i termave të mundshëm për t'u përfshirë në fjalor, nga burime të gjuhës angleze. Realizimi i mëtejshëm i projektit kushtëzohet nga disponimi i fondeve përkatëse dhe gatishmëria e palës së AShAK-së.

5. Projekti mbi botimin e librit *Mbrojtja e pemëve dhe e hardhisë*, po realizohet nën kujdesin e AShSh (SShNT) dhe AShAK (SShN), me koordinatör të palës shqiptare Prof. i asoc. Rexhep Uka (AShSh, SShNT) dhe të palës kosovare Prof. dr. Ismail Pireva (AShAK, SShN).

Projekti dy vjeçar (2011-2013) ka si objekt hartimin dhe përgatitjen për shtyp të botimit *Dëmtuesit e pemëve frutore dhe të hardhisë*, mbështetur nga AShSh dhe nga AShAK, me autorë nga universitete të Shqipërisë dhe Kosovës. Ky botim do të jetë vepra e dytë kushtuar problemeve të rëndësishme të frutikulturës dhe të vreshtarisë dhe është në vazhden e realizimit të dy projekteve të mëparshme, si bashkëpunim mes shkencëtarëve nga Shqipëria dhe Kosova.

Gjatë vitit 2012 janë realizuar dy takime ndërmjet autorëve (Rexhep Uka dhe Isamil Pireva) në Prishtinë dhe Tiranë për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me tematikën dhe aspekte të veçanta të botimit të librit.

Aktualisht pothuajse janë përfunduar dhe përmbledhur idetë e këtij botimi dhe është parashikuar që në qershor 2013 të bëhet takimi i fundit për të njëzuar

punimet e çdo autori veçmas, për të formatuar e redaktuar nga pikëpamja shkencore dhe terminologjike tekstet, dhe në muajin shtator të dorëzohet gjithçka së bashku me skicat tabelat dhe fotografitë që përbëjnë një ngarkesë jo të vogël të këtij botimi.

6. Projekti SPALKO: “Sistemet pastorale dhe kultura pastorale, trashëgimi në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe planifikimin e territorit” me koordinator të palës shqiptare Prof. dr. A. Proko (AShSh, SShNT) dhe të palës kosovare Akad. L. Susuri (AshAK, SShN). Grupi i studiuesve shqiptarë ka në përbërje studiues nga Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Histori-Filologjisë, (Universiteti i Tiranës) dhe Departamenti i Menaxhimit dhe Shfrytëzimit Pyjor, Fakulteti i Shkencave Pyjore (Universiteti Bujqësor i Tiranës).

SPALKO planifikon të investigojë funksionet dhe shërbimet e ekosistemeve në sistemet silvo-pastorale (SP) të përdorimit të territorit. Në fokus të këtij studimi ka qenë menaxhimi i qëndrueshëm i ekosistemeve natyrore dhe ruajtja e biodiversitetit të SP në mjedise të ndryshme socio-ekonomike kulturore dhe bioklimatike. Bazuar në përparësitë strategjike të kërkimit të Agjendës së Kërkimit të Pyjeve Mesdhetare (MFRA) SPALKO synon të: (i) vlerësojë ndikimet mbi klimën dhe ndryshimet në përdorimin e territorit në diversitetin e SP; (ii) vlerësimin e rrezikut, menaxhimin dhe efektet e tyre në SP; (iii) vlerësimin e të mirave dhe shërbimeve të SP, duke përfshirë ato të tregtueshme dhe të patregtueshme.

Për shkak të mungesës së kapaciteteve të ASHAK, ekipi krijoi lidhje me dy projekte që zhvillojnë veprimtarinë në zonën e planifikuar dhe kanë fusha të përafërta studimi:

1. Projekti EFMS (Francë) mbi studimin e indikatorëve gjeografikë në veri të Shqipërisë dhe jugperëndim të Kosovës;

2. Projekti i DAAD: Open Standards for the practices of conservation

Janë evidentuar një sërë zonash me karakteristika të ndryshme dhe tregues të larmishëm, ku veçojmë: (i) për Shqipërinë: Bjeshkët e Çerremit, Lugu i Vocit, Ragami, Korrabi, Shishtaveci; (ii) për Kosovën: Rugova, Malësia e Sharrit, Malësia e Gjakovës. Nëpërmjet analizës *kross-cutting*, rezultoi se për t’u marrë si objekte studimi përparësore, bazuar në veçoritë e tyre, janë: Lugu i Vocit (Tropojë) dhe Malësia e Ragamit (Pejë).

Në kuadër të bashkëpunimit me projektin e parë janë realizuar disa takime me aktorët e interesuar në zonë dhe janë grumbulluar një sërë të dhënash lidhur me kushtet e vendit.

Në bashkëpunim me palën franceze po evidentohen specialistë të rinj, të cilët në bashkëpunim me ata francezë, të zhvillojnë studimin në kuadër të PhD.

Në bashkëpunim me ekspertët gjermanë dhe një anglez është organizuar një *workshop* në Shkodër, me studentë potencialë për t'u përfshirë në projekt, ku u zhvillua një praktikë interaktive mbi metodologjinë e re bazuar në "Open standards for the practices of conservation", në fund të të cilit u shpërndanë dhe çertifikata. Një grup studentësh me edukim në shkencat pyjore, trajtoi në mënyrë të veçantë problematikën e lidhur me silvo-pastoralizmin dhe përpunoi metodologjinë për analizën diagnostike të këtyre sistemeve në zonë.

Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë

- ***Statuti i Këshillit Shkencor Ndërakademik ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë***. Akad. S. Bushati në bashkëpunim me Këshillin Ekzekutiv të AShSh, Tetor 2012.

Këshilli Shkencor Ndërakademik është një organizatë jofitimprurëse e ASA dhe MASA, që punon së bashku, me qëllim që të nxisë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit midis akademive, të ofrojë këshillim për politikën shkencore në fushën e kërkimit dhe zhvillimit me interes të ndërsjelltë për bashkësinë shkencore.

Çdo Akademi Kombëtare e Shkencave dhe/apo Arteve, në vazhdim e përmendur si Akademi, e cila ndodhet në Ballkan, ka të drejtë anëtarësi.

Anëtarët e KSHN janë Kryetari dhe kryhesohet prej tij, Sekretari Shkencor, Zëvendës-kryetari dhe Kryetarët e Seksioneve të Akademive anëtare, pesë anëtarë nga secila Akademi, anëtarësim ky që ripërtërihet sipas zgjedhjeve siç parashikohet në statutet e Akademive anëtare dhe mund të shtyhet më tej sipas diskutimeve dhe marrëveshjes midis Akademive anëtare. Këshilli mbledhet të

paktën një herë në vit dhe përcakton politikën e përgjithshme të KSHN, miraton deklaratat e lëshuara në emër të Këshillit dhe përgatit programet. Vendimet e KSHN merren mbi bazë marrëveshjesh dhe në veçanti me shumicë votash të anëtarëve të KSHN. Këshilli Shkencor Ndërkademi zbaton politikat e miratuara prej tij, ndërmerr veprimtari dhe projekte, dhe përgatit propozimet për ngritjen e komiteteve përkatëse, të përzgjedhura në kohën e duhur dhe i mbikqyr ato.

Ç. Projekte ndërkombëtare në Kuadër të Programeve të BE (FP6 dhe FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera

1. Projekti “**BallkanGEONet—Ballkan GEO Network – drejt përfshirjes së vendeve të Ballkanit në iniciativat e vëzhgimit global të Tokës**” (BalkanGEONet—Balkan GEO Network – Towards Inclusion of Balkan Countries into Global Earth Observation Initiatives); numri i Projektit: 265176, në kuadër të Programit FP7-ENV-2010. Bashkëdrejtues të projektit janë Prof. dr. I. Milushi, Dr. H. Reçi etj. të IGjEUM, UPT, ndërsa koordinimi dhe veprimi mbështetës, në kuadrin e anëtarëve shqiptarë të bordit këshillues të zgjeruar, realizohet nga **Akad. S. Bushati (përfshirë Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike, AShSh)** dhe E. Canaj, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe e Mjedisit, të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Objektivi i projektit përfshin identifikimin e vëzhgimeve të Tokës në Shqipëri (për të gjitha fushat e kërkimit) sikurse në të gjitha shtetet pjesëmarrëse në projekt.

Janë krijuar bazat e të dhënave të institucioneve të EO-ve, me të gjithë të dhënat e hollësishme, me adresimet ku ato ndodhen, formatin dhe gjendjen aktuale të tyre për sa i përket standardeve.

2. Projekti “**Development of hydrological and hydraulic study of regulation of Skadar Lake and Bojana River water regime**” – (Zhvillimi i studimit hidrologjik dhe hidraulik i rregullimit të regjimit uhor të Liqenit të Shkodrës dhe Lumit Buna), në kuadër të **Projektit IPA**, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Malit të Zi (partner lider) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (partner). Periudha 2012-2013. Numri i kontratës: 2012/287-023; koordinator për palën shqiptare është **Akad. S. Bushati**.

Të dyja akademitë e shkencave realizojnë kryerjen e studimit në bashkëpunim me institucionet e specializuara në fushën e hidrometeorologjisë; kështu, AShSh

bashkëpunon me Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe të Mjedisit (IGjEUM) të UPT.

Ky projekt ka si objektiv kryesor studimin hidrologjik, hidraulik dhe hidrogeologjik të sistemit ujqor të Liqenit të Shkodrës dhe të Lumit Buna, çka do të arrihet nëpërmjet realizimit të disa veprimtarive shkencore dhe monitoruese.

Gjatë vitit 2012 është realizuar digjitalizimi i basenit të sistemit ujëmbledhës Drin – Moraça – Liqeni i Shkodrës – Buna. Janë në proces studimet për hartën hidrogeologjike të këtij sistemi ujqor.

3. Projekti “KHE-STO (IPA Adriatik) për shfrytëzimin e TIK në transport gjatë krizave mjedisore” në kuadër të Projektit IPA.

Po punohet për përgatitjen e fillimit të realizimit të projektit me drejtues **Akad. N. Frashëri**.

4. Projekti “HP-SEE”, në kuadër të Programit të Komisionit European FP7, me drejtues të ekipit lokal Akad. N. Frashëri.

Projekti synon zhvillimin e infrastrukturës kompjuterike për përpunim paralel dhe të aplikimeve përkatëse në vendet e Europës Juglindore, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës.

Ka përfunduar testimi i aplikimit GIM për inversionin e anomalive gravimetrike me teknikat e paralelizmit OpenMP dhe MPI duke shfrytëzuar në distancë sistemet paralele në Hungari dhe Bullgari. Rezultatet janë paraqitur në konferenca ndërkombëtare.

Është mbështetur aplikimi i fizikës i Fakultetit të Shkencave të Natyrës HMLCQD për modelimin e kuarkeve, si dhe fillimi i një aplikimi të ri nga hidrodinamika. Është realizuar një seminar teknik mbi sistemet paralele.

5. Projekti “SEERA-EI” që financohet nga Programi Kuadër 7 i Komisionit Evropian, me drejtues **Akad. N. Frashëri**, të ekipit lokal pranë UPT ka për qëllim harmonizimin e strategjive të zhvillimit të Infrastrukturës kërkimore në rajon dhe ka zhvilluar veprimtari në Shqipëri në përputhje me detyrat e projektit për rajonin e Europës Juglindore me pikësynim integrimin në zonën europiane të kërkimit ERA. Në këtë projekt bashkëpunohet me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

U realizuan veprimtaritë për përfundimin e projektit në prill 2012. U bënë dy referime mbi projektet e infrastrukturës në seminarët e organizuara nga AITA (Shoqata Shqiptare e TIK) dhe MASH dhe u mbështet realizimi i seminarit të MASH.

6. Projekti “**IDEALIST’2014**”, që financohet nga Programi Kuadër 7 i Komisionit European me partner në Shqipëri **Akad. N. Frashëri** synon nxitjen e pjesëmarrjes në FP7 nëpërmjet qarkullimit të informacioneve mbi projekt-propozimet dhe mbështetjen e projekt-propozimeve të tilla.

Është marrë pjesë në veprimtaritë e projektit dhe janë qarkulluar informacionet mbi kërkesat për partner nga propozues projektsh në fushën e TIK në FP7.

7. Projekti “*Indigenous traditional plants for preparing added value new products with different applications*” (*Bimët tradicionale autoktone për përgatitjen e produkteve të reja me vlerë të shtuar me përdorime të ndryshme*) në kuadër të Programit FP7, SEE ERA NET PLUS, BALKFITOPROD me ekspert lokal **Akad. i asoc. I. Malollari** (2010-2012).

Objekti i projektit është ruajtja e bimëve tradicionale aromatike-mjekësore të përbashkëta për vendet e Ballkanit Perëndimor, me potencial të pamjaftueshëm shfrytëzimi, duke i përdorur për të përgatitur shtesa ushqyese ose produkte farmaceutike të reja. Objektivat shkencorë të projektit lidhen me mundësinë e shfrytëzimit të përvojës dhe traditës të tri shteteve partnere: Rumanisë, Serbisë dhe Shqipërisë, në procesimin, investigimin e strukturës kimike dhe biokimike dhe në krijimin e produkteve të reja origjinale. Rezultatet e pritshme janë: Zgjedhja e bimëve aromatike dhe mjekësore autoktone me përdorim të gjerë, dizenjimi i metodave të reja të ekstraktimit dhe identifikimi i drejtimit të përdorimit. Metodave të reja që do të përdoren, bazohen në analizën spektrale, GC-MS, HPLC dhe në teknikat e reja të membranave. Projekti do të ketë një impakt ekonomik, ekologjik dhe social në popullsinë e kësaj zone.

8. Projekti “**National background report on energy of Albania (Report of analysis and evaluation of Energy Statement, the current and prospective profitability, liquidity and financial stability of energy system in Albania)**” – *Raporti bazë kombëtar për energjinë (Raport i analizës dhe vlerësimit të gjendjes së energjisë, përfitimit aktual dhe perspektiv, likuiditetit dhe qëndrueshmërisë financiare të sistemit energjetik në Shqipëri)* në kuadër të Programit WBC – INCO.NET “Energy Research in the Western Balkans”, February – April, 2012, **Akad. S. Bushati**, A. Leskoviku, S. Dima, S. Theodorjani, P. Berberi, E. Agolli & Aliaj B.

Në kuadër të këtij projekti, u hartua studimi mbi gjendjen e energjisë në Shqipëri dhe pritshmëritë e saj në përputhje me objektivat kombëtare në këtë fushë.

9. Projekti “*SEE PhytoChem Network*” (Rrjeti SEE PhytoChem), sponsorizuar nga UNESCO Participation Programme Unit për Rajonin SEE. Grupi kombëtar shqiptar drejtohet nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike (**Akad. e asoc. E. Kongjika, Akad. S. Bushati**) në bashkëpunim me personin përfaqësues kombëtar Prof. dr. P. Lazo (FShN, UT), Dr. S. Çeliku (kompani private) (2012 - 2014).

Qëllimi i projektit është krijimi i Rrjetit kombëtar shqiptar duke aktivizuar bashkëpunimet shkencore midis vendeve në fushën e fitokimisë dhe kimisë së produkteve natyrale. Bazën për krijimin e këtij rrjeti e përbëjnë kapacitetet njerëzore dhe infrastruktura shkencore bashkëkohore (GC/MS, GC, AAS). Objektivi i rrjetit është standardizimi dhe hartimi i protokolleve për testet dhe eksperimentet laboratorike, për karakterizimin e produkteve natyrale, prodhimi pilot i produkteve etj.

Fillimisht po punohet në kërkim të përbashkët për bimën e çajit të malit (*Sideritis* sp.) nga Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia dhe Serbia.

10. Projekti “*Emergency damage risk assessment of Archaeological monuments in Albania by new geophysical methods*” (EDRAAMG) (*Vlerësimi i rrezikut të dëmtimeve emergjente të monumenteve arkeologjike sipas përdorimit të metodave të reja gjeofizike*), është zhvilluar në kuadër të Programit të Rrjetit të Akademive të Vendeve të Botës së Tretë për kërkuesit e rinj, (TWAS), me koordinatör kërkuesin e ri, Dr. Hamza Reçin dhe drejtues **Akad. S. Bushati**.

Objektivat e projektit janë futja në përdorim e teknologjive të reja gjeofizike me metoda Tomografike me teknikë instrumentale të ditëve të sotme. Testimet u bënë edhe me një metodë gjeofizike të avancuar, atë gjeoradare. U kryen cikle eksperimentale në lidhje me përdorimin e teknologjive të reja gjeofizike në studimet e trashëgimisë kulturore: përdorimi i tomografisë elektrike në vendbanimet e vjetra (Bylis dhe Apolloni). Gjithashtu, në këtë kuadër u punua për optimizimin e metodikave të matjeve, të përpunimit e interpretimit, bazuar në investigime edhe në site të tjera arkeologjike si në Apolloni e në Bylis. Rezultatet e studimit janë shumë interesante në drejtim të efektivitetit të studimeve arkeologjike

në përgjithësi: cilësi, shpejtësi dhe kosto e ulët. Është përgatitur raporti i studimit dhe janë bërë paraqitje dhe publikime në lidhje me studimin.

11. Projekti “Western Balkans regional R & D Strategy for Innovation” (*Strategjia K&Zh e Rajonit të Ballkanit Perëndimor për inovacionin*), projekt i Bankës Botërore me mbështetjen e Unionit European me asistencën e Komisionit, Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit në kuadër të “Horizon 2020”. Ekipi shqiptar: E. Mataj, K. Odeta, V. Ajazi, **Akad. S. Bushati**, E. Agolli & D. Mezini; nëntor 2011 - maj 2013.

Është hartuar draft-strategjia rajonale dhe gjatë vitit 2013 do të paraqitet me palët e interesit në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Strategjia do të aprovohet dhe zbatimi i saj do të fillojë në vitin 2015, me mbështetjen dhe të Programit IPA.

12. Projekti “Consolidation of the Environmental Monitoring System in Albania” (*Përforcimi i Sistemit të Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri*) në kuadër të Programit CEMSA PROJECT, nga Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave (2008-2012) me mbështetjen e Programit IPA të Komisionit European. **Akad. i asoc. I. Malollari**, anëtar i Komitetit drejtues.

Vazhdon puna për trajtimin e modelit matematik të procesit dhe për gjetjen e mënyrës më të përshtatshme për vlerësimin ekonomik të sipërmarrjes me përdorim të teknologjive alternative të trajtimit të biomasës agropjore.

13. Projekti “Conservation and investigation of the biodiversity of species from the Gesneriaceae family (Harberlea sp., Ramonda sp.) occurring in different habitats on the Balkans by establishing an in vitro gene bank” (*Konservimi dhe zbulimi i biodiversitetit të specieve të fam. Gesneriaceae (Harberlea sp., Ramonda sp.) nga habitate të ndryshme të Ballkanit për ngritjen e një banke gjenetike in vitro*) (DO 02/236), është zhvilluar në kuadër të Programit të Fondit Ndërkombëtar për Shkencën të Bullgarisë, Departamentit të Fiziologjisë së Bimëve dhe Biologjisë Molekulare të Universitetit të Plovdivit. Koordinatorë e palës shqiptare: **Akad. e asoc. E. Kongjika**, koordinator i palës bullgare Prof. dr. Ivan Minkov (2008 – 2012).

Projekti është realizuar në bashkëpunim me Departamentin e Bioteknologjisë të Fakultetit të Shkencave Natyrore të UT (Prof. dr. Zh. Zekaj, Prof. i asoc. A. Bacu, Dr. V. Sota). Në vitin 2012 u paraqit raporti përfundimtar i grupit të përbashkët të punës, ku jepen në formë të përmbledhur rezultatet e fituara:

- Kartografimi, kërkimi dhe hetimet në terren për popullatat, lokalitetet dhe habitatet; zhvillimi i një sistemi rezultativ të vlerësimit të riskut dhe ruajtja në data-base e gjithë informacionit të ri për *Gesneriaceae* në Bullgari, Greqi, Shqipëri dhe Maqedoni;

- Ngritja dhe ruajtja e bankës gjenetike *in vitro*, që mbulon biodiversitetin natyral të popullatave kryesore të bimëve të “ringjalljes”, të vendeve të Ballkanit, (Bullgari, Shqipëri, Greqi, Maqedoni) dhe lejon akses gjatë gjithë vitit. Banka do të shërbejë për përdorim të bimëve për qëllime kërkimi dhe didaktike. Në një të ardhme të afërt, kjo bankë gjenetike do të jetë bazë për krijimin e Bankës së Bashkuar Gjenetike Ballkanike për familjen *Gesneriaceae*. Ekipi ka kryer me sukses përshtatjen e bimëve *in vitro* dhe riintroduktimin e tyre në habitatet natyrale;

- Analiza në bimët *Gesneriaceae in vitro* për tregues të ndryshëm dhe në veçanti, për të zbuluar polimorfizmin e nukleotidëve të veçantë (SNPs), që mund të jetë indikator për modele të pazakonta të shpërndarjes së polimorfizmit në popullatat e *Haberlea rhodopensis*. Nga grupi shqiptar është arritur përcaktimi i kariotipit dhe kariogramës me metoda citogjenetike dhe i polimorfizmit të ADN me metoda të markerëve molekularë RAPDs për speciet e gjinisë *Ramonda*;

- Zhvillimi i një skeme të modelit teknologjik për prodhimin e ekstrakteve aktive të OPC dhe AOA, për përdorimin e tyre në produktet kozmetike dhe farmaceutike (analiza të aktivitetit antimikrobiale dhe antioksidant);

- Si rezultat i aktivitetit shkencor të kryer është krijuar një strategji për konservimin dhe investigimin e përfaqësuesve ballkanikë të familjes *Gesneriaceae*. Është krijuar dhe përdoret një *website* i projektit. Ideja e grupit ballkanik për të ardhmen, është vazhdimi i punës në këtë drejtim dhe krijimi i një grupi shkencor ballkanik për *Gesneriaceae*, me qendër në Universitetin e Plovdivit, Bullgari.

Në kuadër të këtij projekti është botuar artikulli “*Initial determination of polymorphism and in vitro conservation of some Ramonda serbica and Ramonda nathaliae populations from Albania, Macedonia and Bulgaria*”, me autorë Daskalova E., Dontcheva S., Zekaj Zh., Bacu A., Sota V., Gashi B., Minkov I., Toneva V. & **Kongjika E.** në revistën shkencore “Biotechnology &

Biotechnological Equipments”, 2012, v. 26(1) Special Edition, 16-25. (Impact Factor 0.706), i paraqitur dhe *online*.

14. Projekti **“Monitoring of evolution of the sediments in the Shkodra Lake since 2003”** (*Monitorimi i evolucionit të sedimenteve në liqenin e Shkodrës*) me koordinator shqiptarë **Akad. S. Bushati (AShSh)** dhe pjesëmarrës R. Koçi (IGJEUM, UPT) dhe nga institucionet italiane E. Dliozzi dhe I. Mazzini (Laboratori Paleontologjik i Universitetit të Romës-III).

Studimi konsiston në njohjen e evolucionit sedimentologjik të liqenit të Shkodrës, si një vazhdimësi e kryerjes së Projektit NATO-SfP (2002-2006), tashmë të realizuar nga një ekspeditë e përbashkët e Akademisë së Shkencave dhe IGJEUM, UPT, me Laboratorin Paleontologjik të Universitetit Roma-III, në liqenin e Shkodrës. Studimi është në proces të kryerjes së analizave në Universitetin e Roma-III. Rezultatet e Projektit do të kontribuojnë në studimin e evolucionit të liqenit të Shkodrës e më gjerë, me një ndihmesë me rëndësi në shkencat e tokës në përgjithësi, dhe konkretisht, edhe për studime që kryhen në këtë rajon, si ai i studimit të *Sistemit uhor Drin-Liqeni i Shkodrës-Buna*.

15. Projekti **“Për sistemin kompjuterik paralel”**, me sponsorizim nga qeveria kineze me drejtues **Akad. N. Frashëri**.

Po punohet për përgatitjen dhe instalimin e sistemit kompjuterik, i cili do të vihet në shërbim të komunitetit kërkimor të vendit.

16. Projekti **“Propozime legjislative dhe hartimi i rregulloreve në lidhje me praktikën e fundit të jetës”**, aktivitet i realizuar në kuadër të bashkëpunimit të Akademisë së Shkencave (**Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike**) me Katedrën e të Drejtës Kishtare të Universitetit të Bolonjës.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë duke pasur ndihmën shkencore të Dr. Federica Botti, Universiteti i Bolonjës, eksperte në fushën e legjislacionit mbi eutanazinë në vende të ndryshme dhe në veçanti në Zvicër, Australi dhe Itali, ka analizuar dhe diskutuar për përgatitjen e propozimeve legjislative dhe hartimin e rregulloreve në lidhje me praktikën e fundit të jetës.

Propozimet do të paraqiten në qeveri, parlament dhe ministritë në fjalë, në mënyrë që ato të mund të marrin vendimet e nevojshme për të përshtatur legjislacionin shqiptar dhe praktikën administrative me standardet e vendosura nga Bashkimi European.

17. Projekti **“Vizita shkencore”** në kuadër të Programi ERASMUS-MUNDUS (EM2-STEM) financuar nga Komisioni European, EU, nga **Akad. e asoc. A. Veveçka**.

U krye një vizitë 1 mujore (19 maj-16 qershor 2012) në Departamentin e Fizikës dhe të Energjisë, Universiteti i Limerick-ut, Irlandë. U mbajt referati në Institutin e Materialeve dhe Shkencës së Sipërfaqes, Universiteti i Limerick-ut **“Bulk Nanostructured Materials by Severe Plastic Deformation (SPD)”**. **“Materialet Nanostrukturorë masivë të përftuar me anë të Deformimit të Fortë Plastik”**, 6 Qershor 2012. Gjithashtu në kuadër të projektit, u realizua punë kërkimore mbi provat në tërheqje të një lidhjeje alumini të presuar me deformim të fortë plastik (DFP).

18. Projekti **“Multifunctional water treatment system based on ultrasensitive detection and purification nanoplatfoms for removal of environmental pollutants”**, (MICINN, Spain-Japan collaboration project, PLE2009-0050, November 2009 - October 2012). Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

19. Projekti **“Evaluation of the calcium-sensing receptor as a novel candidate tumor suppressor gene and therapeutic target inneuroblastic tumors”**, CELLEX Foundation. (100.946,00 €) (01/01/2011-31/12/2013), Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

20. Projekti **“Nanoparticle-based Sensors for Detection of Chemical and Biological Threats”**. (SfP 983807)”, NATO. (22/06/2010-21/06/2013), Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

21. Projekti **“Multifunctional Nanoplatfoms For High Sensitive Pollution Control and Purification of Water”**, MICINN. (01/01/2011-31/12/2013), Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

22. Projekti **“Desenvolupament d’un biosensor electroquímic basat en nanopartícules per la detecció ràpida i senzilla de seqüències de DNA”**, subcontracted by VETGENOMICS spin-off. (01/12/2010-30/11/2013), Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

23. Projekti **“NANOHEROES NANOMaterials for Highly on-off Electroswitchable Recognitions capabilities with Outstanding ElectrobioSensing applications”**, MICINN. (01/01/2012 - 31/12/2014), Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

24. Projekti **“Project full title Point of Care Diagnostics for rapid and cheap pathogen detection of companion animals”**, Project acronym POC4PETS, Funding scheme Research for SMEs, Work program topic, FP7-SME-2012-1, Start date 01/09/2012, End date 31/08/2014, Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

E. Aplikime të reja për projekte në kuadër të programeve e organizmave ndërkombëtarë.

Gjatë 2012 është bërë një punë e madhe në lidhje me aplikimet e reja për projekte në kuadër të programeve e organizmave ndërkombëtarë, për disa prej të cilave janë marrë edhe konfirmimet për pranimin e shprehjes së interesit të projekteve, në vijim:

1. Projekti **“Nanosystems for early Diagnosis of Neurodegenerative Diseases, (NADINE)”**, FP7 Proposal for a Cooperation Project, NMP-2009-4.0-3, Development of nanotechnology-based systems for molecular diagnostics and imaging. (01/09/2010-31/08/2015) Drejtues kërkimesh, **Akad. A. Merkoçi**;

2. Projekt **“Empowering women in sciences - Strengthens their capacity to the role of quality society development”**. (Acronym: EWS-QSD). August. 2012; **Akad. S. Bushati S.**, B. Shkreta;

3. **Akad. N. Gruda** ka kryer **detyrën e ekspertit** (në emër të Zyrës Federale të Bujqësisë dhe Ushqimit të Gjermanisë), për vlerësimin, miratimin dhe shoqërimin e projekteve kërkimore shkencore (më shumë se 56 projekte kërkimore shkencore) nga aplikimet e universiteteve dhe shkollave të larta, institucioneve kërkimore shkencore, organizatave shtetërore e OJQ, ndërmarrjeve të prodhimit e shërbimit të fushës; si edhe raportimin e risive në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit eksperimental në Ministrinë Federale të Ushqimit, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Shpërndarja e projekteve për seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike paraqitet si me poshtë:




Fig. 7. Shpërndarja e projekteve

Siç shihet nga grafiku në aktivitetin kërkimor të AShSh-së dominojnë projektet ndërkombëtare, fryt i përpjekjes së akademikëve dhe i nivelit të tyre të performancës.

III. PROJEKTE TE REALIZUARA NGA BIBLIOTEKA SHKENCORE E AKADEMISË

Projekti "**Burimet elektronike për Shqipërinë**" ERA 2011- 2012 (**Electronic Resources for Albania**) (www.akad.edu.al/era), i realizuar nga marrëveshja e **AShSh** me **IZUM**-in (Informacioni Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor), Slloveni dhe **EIFL**-in (Informacioni Elektronik për Bibliotekat), Holandë, me koordinatorë të palës shqiptare Dr. M. Ymeri, përgjegjëse e BshASh-së.

Duke pasur parasysh përparësitë e librit elektronik dhe faktin e njohur tashmë, që paradigma e informacionit ka ndryshuar, Biblioteka e Akademisë së Shkencave ka ndërmarrë në vitin 2011 një projekt mjaft ambicioz, në kontekst të të cilit ka krijuar mundësinë e aksesimit në *botimet më prestigjioze elektronike të huaja, nga fusha të shumëllojshme dhe me peshë të shkencës.*

Në këtë mënyrë, Akademia është një hap përpara edhe për krijimin e e- qytetarit, dhe reflekton edhe ndryshimet që po ndodhin në botën akademike, kur lexuesi është bërë përdorues i fortë i mjeteve elektronike, dhe posaçërisht në arsimin e lartë, ku në kontekstin e zhvillimit të të mësuarit edhe teknologjik, kanë ndryshuar metodat e dhënies dhe marrjes së mësimit.

Për të kuptuar rëndësinë e projektit, por edhe motivet që e shtynë Kryesinë e Akademisë të mobilizojë në një projekt të tillë, si dhe për vetë ndikimin e madh që pati dhe që shpresojmë të ketë edhe në të ardhmen, po paraqitet më poshtë një përshkrim i projektit.

Ky projekt synon krijimin dhe funksionimin e shërbimit të informacionit për aksesin e burimeve elektronike në dispozicion për komunitetin akademik në Shqipëri. Ai është bërë një mjet më shumë në duart e specialistëve, për të pasur burime të shumta informacioni me nivel të lartë shkencor. Ky projekt që filloi në gjashtëmujorin e dytë të 2011 dhe vijon, synon të

- Sigurojë aksesin në burimet ndërkombëtare elektronike për të mbështetur arsimin, kërkimin shkencor dhe zhvillimin e përgjithshëm.
- Nxitjen e botimit të rezultateve të kërkimit shkencor shqiptar në revista prestigjioze ndërkombëtare.
- Sigurimin e infrastrukturës informuese për vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor dhe identifikimin e kompetencave ndërkombëtare

Përfituesit që kanë akses të lirë nga burimet elektronike të ofruara nga projekti ERA2011-2012, janë:

- Universitetet publike,
- Bibliotekat publike, në varësi të numrit të studentëve që kanë si përdorues,
- Akademia e Shkencave,
- Bibliotekat speciale,
- Institutet kërkimore shkencore.

Deri tani janë gjithsej 40 institucione, të cilat natyrisht përbëjnë institucionet themelore të komunitetit shkencor në Shqipëri dhe shumë biblioteka publike. Ndërkaq, *për herë të parë*, ky shërbim u vu në dispozicion të përdoruesve jo vetëm nëpërmjet institucionit përkatës, por edhe nga kompjuteri personal i shtëpisë (Remote Access). Çdo anëtar i një biblioteke të përfshirë mund t'i konsultojë këto materiale përmes adresës së vet private.

Numri i përdoruesve është rreth **2000** punonjës shkencorë, studiues, studentë në master, pedagogë etj.

Burimet elektronike që mund të konsultohen, përfaqësojnë libra, revista shkencore, monografi në format elektronik, që do të jenë të disponueshme për një

vit me akses falas dhe që janë blerë në agjencitë më prestigjioze botërore. Burimet kryesore janë:

- **ebrary Academic Complete**
- **EBSCO Academic Search Premier**
- **Emerald Management eJournal Collection**
- **Multi-Science Journals Collection**
- **ProQuest Central**
- **Taylor & Francis Library**
- **New England Journal of Medicine**
- **Oxford English Dictionary Online**
- **Oxford Textbook of Medicine**
- **Oxford Reference Online**
- **Cambridge Journals Online**
- **OECD-iLibrary**
- **IOPscience**

Për të realizuar këtë projekt janë organizuar me koordinator kryesor stafin e Bibliotekës, dy konferenca kombëtare, ku kanë marrë pjesë rreth 100 persona, punonjës të fushës, por edhe vendimmarrës nga universitetet publike dhe private.

II. KONFERENCA SHKENCORE

A. Konferenca shkencore ndërkombëtare

Në bashkëpunim me institucione të tjera dhe në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet akademive, janë zhvilluar konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare, duke trajtuar dhe paraqitur problematikat kryesore që shqetësojnë shoqërinë dhe ekonominë shqiptare. Janë dhënë rekomandime me vlerë për zgjidhjen e këtyre problemeve si për pyjet, për përdorimin e metodave bioteknologjike në mjekësi, bujqësi, mjedis, sigurinë ushqimore etj., për ruajtjen e biodiversitetit natyror dhe bujqësor, në industrinë e përpunimit të perimeve dhe në

fushën e industrisë kimike, të prodhimit ushqimor, të vlerësimit të ruajtjes së mjedisit, për trashëgiminë kulturore etj.

Në kuadër të bashkëpunimeve me institucione të tjera, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet akademive apo të paraqitjes së rezultateve të përfundimit të projekteve, AShSh ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e dërguara nga Anëtarët e rregullt dhe ata të asociuar të AShSh-së, rezulton se ka pasur një pjesëmarrje të gjerë në veprimtari shkencore ndërkombëtare, të cilat po i citojmë përmbledhtazi sipas seksioneve.

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

A. Konferenca Shkencore Ndërkombëtare

Veprimtaria shkencore në fushë të studimeve albanologjike është realizuar në disa forma të kërkimit e të komunikimit shkencor dhe në organizimin e aktiviteteve të larmishme shkencore, si konferenca, simpoziume, tryeza e promovime të rezultateve shkencore, me pjesëmarrje kombëtare e ndërkombëtare.

1. "Akademi Solemne kushtuar 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë" (26 nëntor 2012), me pjesëmarrjen e studiuesve historianë të njohur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, diaspora arbëreshe, Greqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania.

Pas fjalës së hapjes nga kryetari i Akademisë së Shkencave Akad. Gudar Beqiraj dhe përshëndetjes nga zv. ministrja e Arsimit dhe Shkencës, Nora Malaj, u mbajtën 12 referate:

1. Prof. **Kristo Frashëri** - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë - fundi i një epoke të errët dhe fillimi i një epoke të re

2. Prof. **Nikolla Pano** (SHBA) - Fan Noli, Komuniteti Shqiptaro - Amerikan dhe Shqipëria

3. Prof. **Arben Puto** - Koncerti europian dhe çështja shqiptare

4. Prof. **Kristaq Prifti** - Pavarësia e Shqipërisë dhe themelimi i shtetit shqiptar nga Ismail Qemali

5. Prof. **Paskal Milo** - Nacionalizmi shqiptar dhe Pavarësia
6. Prof. **Hivzi Islami** (AShAK) - Lufta kundër faktorit demografik shqiptar si strategji afatgjatë e politikës serbo-jugosllave
7. Prof. **Tito Johalas** (Greqi) - Dy fjalë të shkurtra për një periudhë të gjatë
8. Prof. **Mirie Rushani** (Shkup) - Identiteti kombëtar dhe ndërtimi i shtetit shqiptar në dimensionin europian
9. Prof. **Bernd Fischer** (SHBA) - The use of historical documents in Albanian History (Përdorimi i dokumenteve historike në Historinë e Shqipërisë)
10. Prof. **Francesco Altimari** (Itali) - Arbëreshët dhe fillimet e Rilindjes Shqiptare
11. Prof. **Pëllumb Xhufi** - Elita të vjetra e të reja në prag të Pavarësisë
12. Prof. **Michael Schmidt-Neke** (Gjermani) - Shqipëria kurrë nuk bëhet shtet - Zërat ndërkombëtarë kundër Pavarësisë së Shqipërisë

Fjalën e mbylljes e mbajti Akad. Muzafer Korkuti, i cili vlerësoi kontributin shkencor të historianëve që referuan, duke përfunduar se variantet e plota të referateve, do të botohen në një vëllim më vete nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

2. Studimet gjuhësore dhe kulturore shqiptaro-greke: Arritje dhe Perspektiva (24-25 mars 2012), Konferenca e parë ndërkombëtare e Studimeve gjuhësore dhe kulturore shqiptaro-greke, e cila u organizua nga "Lidhja filologjike shqiptaro-greke" dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, me mbështetjen e Institutit të Studimeve Greke të Universitetit të Selanikut, të Institutit Italian të Kulturës në Tiranë dhe të Ambasadës të Republikës greke në Tiranë. Merrnin pjesë studiues nga Shqipëria, Greqia, SHBA, Rusia, Italia dhe Gjermania. Në seancën e parë të hapjes së konferencës folën Akad. Jorgo Bulo dhe Dr. Aristotel Spiro (Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji) si dhe përshëndeti ambasadori i Greqisë në Tiranë, Z. Nikolaos Pazios. Konferenca i zhvilloi punimet në dy sesione, ku u trajtuan: aspekte kulturore e gjuhësore të marrëdhënieve shqiptaro-greke; vështrime kontrastive të shqipes dhe greqishtes; shqipja, arvanishtja dhe arbërishtja në rrafsh komparativ; çështje gjuhësore dhe kulturore të emigrantëve etj. Në konferencë u paraqitën 50 kumtesa dhe u zhvilluan diskutime rreth çështjeve të mësipërme. Marrëdhëniet dhe kontaktet e ndërsjella

kulturore gjuhësore midis dy popujve fqinjë, ndër më të vjetrit të Ballkanit, përbëjnë një objekt kërkimi me interes të veçantë shkencor, jo vetëm për studimet shqiptare dhe studimet greke, por dhe për ballkanistikën në përgjithësi. Konferenca ndihmoi për nxitjen dhe inkurajimin e këtyre studimeve dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit në këto fusha.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

A. Konferenca Shkencore Ndërkombëtare

1. *Simpoziumi VIII Ndërkombëtar "Biodiversiteti, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tij, faktorë për zhvillimin e qëndrueshëm rural"*, organizuar nga Qendra e transferimit të teknologjive bujqësore, Fushë-Krujë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti Bujqësor, Departamenti i Prodhimit Shtazor dhe Shoqata ALBAGENE. Nga AShSh, **Akad. e asoc. E. Kongjika** ishte anëtare e Komitetit shkencor. Simpoziumi u organizua me rastin e Ditës europiane të agrobiodiversitetit – EAD, 21 nëntor 2012.

Simpoziumi u organizua për të tretin vit radhazi në bashkëpunim me AShSh (SShNT). Ai u mbajt në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë, të Ushqimit dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe në mjediset e Akademisë së Shkencave. Në të përshëndetën organizatori i simpoziumit, Prof. dr. K. Kume, kryetari i Akademisë së Shkencave, **Akad. G. Beqiraj**, ministri i Bujqësisë, i Ushqimit dhe i Mbrojtjes së Konsumatorit, Prof. dr. G. Ruli, përfaqësuesi i Universitetit të Prishtinës, Prof. dr. H. Mehmeti dhe përfaqësuesi i Universitetit Bujqësor të Tiranës, dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe i Mjedisit, Prof. dr. A. Maçi.

Qëllimi i simpoziumit ishte të paraqiste produktet e përpjekjeve të përbashkëta të komunitetit shkencor që punon në fushën e gjerë të biodiversitetit. Punimet e tij dhanë një mundësi më shumë për të reflektuar mbi arritjet dhe për të diskutuar për veprimtaritë në të ardhmen për të përballuar sfidën për ruajtjen, miradministrimin dhe zhvillimin e biodiversitetit në vendin tonë, në rajon dhe më gjerë, si një sfidë globale.

Në simpozium u mbajtën referate mjaft interesante mbi biodiversitetin dhe çështje të ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të tij (Prof. dr. T. Dishnica, Ministria e Bujqësisë, e Ushqimit dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit), politikat

kombëtare për ruajtjen e biodiversitetit në kontekstin e integritit europian në fushën e mbrojtjes së natyrës (E. Ramaj, Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave) dhe mbi kontributin e rezultateve të projekteve më të rëndësishme, mbi çështjet ligjore për subvencionet e racave të kafshëve të rrezikuara në Shqipëri, si dhe nevoja e tyre për përmirësimin në kuadrin ndërkombëtar dhe të legjislacionit të BE, si ai mbi biodiversitetin malor në Shqipëri, nëpërmjet identifikimit, ruajtjes dhe zhvillimit të vlerës së shtuar të tij (E. Zhezha, F. Voci, SNV – Albania).

Në simpozium morën pjesë me studimet e tyre rreth 120 kërkues të fushave të ndryshme të biologjisë, bujqësisë, ekologjisë etj. U mbajtën 20 punime për biodiversitetin në kafshë dhe 31 punime për biodiversitetin në bimë. Në fushën e biodiversitetit dhe të prodhimit shtazor u prekën probleme të popullatave autoktone deri në rastet e popullatave të vogla në rrezik zhdukjeje, studime të strukturës gjenetike të popullatave të dhive, konsiderata për zhvillimin e programeve rajonale për ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin ekonomik të qëndrueshëm për raca autoktone të gjedhit, të popullatave të peshqve, të bletëve etj. Në seancën e biodiversitetit dhe prodhimit bimor, simpoziumi u përqendrua në probleme lidhur me ruajtjen dhe vlerësimin e gjermoplazmës së kultivarëve autoktonë të specieve me rëndësi për ekonominë e trojeve në Shqipëri dhe Kosovë si ulliri, hardhia, shega, deri tek drithërat dhe perimoret, duhani, luledielli, bimët aromatike-mjekësore, kërpudhat e ngrënshme etj. Një radhë kumtesash prekën problemin e mprehtë të përdorimit të metodave efikase të luftimit të sëmundjeve tek ulliri, molla, gështenja, domatja etj. Një vend të veçantë zunë problemet e agroturizmit, të produkteve tipike shqiptare, përparësitë e vreshtarisë biologjike, vlerësimi krahasues i biodiversitetit në Shqipëri dhe në vendet e rajonit përmes indeksit të diversitetit bio-kulturor. Nga ekspertët të mjedisit u theksua nevoja për përmirësim të legjislacionit për mjedisin dhe në veçanti, për biodiversitetin.

Në simpozium u paraqit edhe *Libri i Abstrakteve*, ndërsa të gjitha referimet në këtë veprimtari janë përgatitur nga autorët si artikuj shkencorë dhe do të botohen së shpejti në një botim të veçantë (*Proceedings*).

B. Konferenca, seminare shkencore dhe përrurime studimesh brenda vendit

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Veprimtaria botuese gjatë vitit 2012 ishte përqendruar kryesisht në botimin e veprave që lidhen me 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë, por dhe të një problematike më të gjerë, që në një mënyrë ose në një tjetër, lidhet me zhvillimet historike, kulturore e gjuhësore gjatë një shekulli të ekzistencës së shtetit shqiptar. Midis këtyre botimeve e veprimtarive promovuese mund të përmendim:

1. Paraqitja e albumit ***Ismail Qemali*** përgatitur nga **Akad. Kristo Frashëri** (18 prill 2012).

Botimi i këtij albumi është një homazh për burrin e madh, arkitektin e Pavarësisë Kombëtare dhe themeluesin e shtetit modern shqiptar. Përmes fotove dhe teksteve që i shoqërojnë ato, përzgjedhur nga kujtimet e Ismail Qemalit dhe dokumentacioni i kohës, albumi hedh dritë në figurën e plakut të urtë dhe në ngjarjen historike të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, më 28 nëntor 1912. Fjalën e hapjes me këtë rast, e mbajti Akad. Gudar Beqiraj, kryetar i Akademisë. Oponentët e botimit (M. Korkuti) vunë në dukje vlerat e këtij botimi për të njohur e popullarizuar figurën e themeluesit të shtetit shqiptar, shoqëruar me propozimin e përsëritur të Akademisë për një shtatore të Ismail Qemalit në Kryeqytet.

2. Përrurim i botimit ***Vepra albanologjike*** e Prof. Tito Johalas (24 mars 2012).

Akademia e Shkencave e Shqipërisë përruroi veprën e albanologut të njohur grek Tito Johalas, i cili vizitoi vendin tonë i ftuar në Konferencën e parë ndërkombëtare "*Studimet gjuhësore dhe kulturore shqiptaro-greke: Arritje dhe Perspektiva*". Prof. Johalas është autor i shumë studimeve nga fusha e albanologjisë. Libri i tij i parë nga kjo fushë i kushtohet figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut në letërsinë dhe historiografinë e Greqisë së re. Veprat e tjera janë kryesisht nga fusha e gjuhësisë, siç është botimi prej tij i fjalorit të M. Bocarit, i fjalorit të P. Kupitorit, i gramatikës së gjuhës shqipe hartuar prej mjekut të Ali Pashë Tepelenes, J. Velara, për të ardhur tek tri veprat e fundit, njëra prej të cilave u kushtohet arvanitasve të ishullit Andros (***Andros, Arvanitët dhe gjuha arvanitas***, 2000); tjetra ishullit Eubea (***Eubea***, 2002); dhe e treta, gjuhës së arvanitasve të ishullit Hidra (***Hidra, gjuha e harruar***, 2005). Këto tri vëllime janë kurorëzimi i një pune e përkushtimi shumëvjeçar i Prof. Johalasit ndaj studimit të gjuhës, kulturës e traditave të arvanitasve të Greqisë; ato përbëjnë një korpus

- **Maltez-da Costa M., De la Escosura-Muñiz A., Nogués C., Barrios L., Ibáñez E., Merkoçi A., *Simple Monitoring of Cancer Cells Using Nanoparticles, Nano Lett., 2012, 12(8): 4164-4171;***

- **Manaj H., Malja A., Malollari I, *Monitoring of pathologies in oil deep refining plant in Albania. Journal of Environmental Protection and Ecology, 12(4): 1707–1714;***

- **Mandija F., Vila F., *Characterization of solid physical properties through dust resuspensión measurements, Geophysical Research Abstracts, Vol. 14, EGU 2012-PREVIEW, 2012, EGU General Assembly, 2012;***

- **Mandija F., Vila F., Lukaj, *Average PM concentrations over the region of Albania, International Conference of Ecosystems (ICE), Tirana, Albania, June 1-6, 2012, Abstract Book: 49;***

- **Marin S., Merkoçi A., *Nanomaterials based electrochemical sensing applications for safety and security, Electroanalysis, 2012, 24(3); 459 – 469;***

- Mayorga-Martinez C. C., Guix M., Madrid R. E., **Merkoçi A.**, *Bimetallic Nanowires as Electrocatalyst for Nonenzymatic Real Time Impedancimetric Detection of Glucose*, *Chem. Commun.*, 2012, 48: 1686-1688;
- Medina-Sánchez M., Miserere S., **Merkoçi A.**, *Nanomaterials and lab-on-a-chip technologies*, *Lab Chip*, 2012, 12: 1932-1943 (Cover article);
- Medina-Sánchez M., Miserere S., Marín S., Aragay G., **Merkoçi A.**, *On-chip electrochemical detection of CdS quantum dots using normal and multiple recycling flow through modes*, *Lab Chip*, 2012, 12: 2000-2005;
- **Merkoçi A.**, Kutter J. P., *Analytical miniaturization and nanotechnologies*”, Editorial, *Lab Chip*, 2012, 12: 1915-1916;
- Montón H., Roldán M., **Merkoçi A.**, Rossinyol E., Castell O., Nogués C., *The use of quantum dots for immunochemistry applications*, *Methods in Molecular Biology*, 2012, 906: 185-192;
- Morales-Narváez E., **Merkoçi A.**, *Graphene oxide as an optical biosensing platform*, *Advanced Materials*, *Adv. Mater.* 2012, 24: 3298-3308;
- Morales-Narváez E., Montón H., Fomicheva A., **Merkoçi A.**, *Signal Enhancement in Antibody Microarrays Using Quantum Dots Nanocrystals: Application to Potential Alzheimer’s Disease Biomarker Screening*, *Analytical Chemistry*, 2012, 84: 6821–6827;
- Morales-Narváez E., Pérez-López B., Baptista Pires L., **Merkoçi A.**, *Ultrahigher quantum dot quenching efficiency by graphene oxide in comparison to other carbon structures*, *Carbon*, 50 (2012): 2987 – 2993;
- Pérez B., **Merkoçi A.**, *Nanoparticles for the development of improved (bio)sensing systems*, *Analytical and Bioanalytical Chemistry*, (2011) 399:1577-1590;
- Pérez-López B., **Merkoçi A.**, *Carbon Nanotubes and Graphene in Analytical Sciences*, *Microchim Acta*, 2012, 179: 1-16;
- Pérez-López B., **Merkoçi A.**, *Nanomaterials based biosensors for food analysis applications*, *Trends in Food Science & Technology*, 22 (2011): 625-639;
- Perfezou M., Turner A., **Merkoçi A.**, *Gancer detection using nanoparticle-based sensors*”, *Chem. Soc. Rev.*, 2012, 41: 2606-2622;

- **Resuli B., Demiraj V., Babameto A. Sema K., Malaj V., Metformine for the treatment of nonalcoholic steatohepatitis.** *Polish Archives of Internal Medicine*, 2012, October, 122, Suppl.1: 68-71;

- **Sadikaj R., Spaho V., Malollari I., Arapi D., Hydrobiological Study of a Sector in the Fierza Lake in Albania, with the Scope of Installing Floatable Plants for Fishes Cultivation,** *Journal of Environmental Protection and Ecology*, 2012, 13(3): 1391, <http://www.jepe-journal.info/journal-content>;

- **Savvas D., G. Gianquinto Y. Tüzel, Gruda N., Soilless culture.** *International Workshop on "Good Agricultural Practices for Greenhouse Horticulture in the Mediterranean and South Eastern Europe Regions*, Amman Jordan, December 9-12, 2012, *Book of Abstracts*: 26-27;

- **Seiti B., Topi D., Malollari I., Lame A., Environmental impact on air pollution from oil extraction and refining industry in Albania.** *Journal of Environmental Protection and Ecology*, 2012, 13(3): 1314, <http://www.jepe-journal.info/journal-content>;

- **Shevchenko Y., Gruda N., Smetanska I., Dry Onion Peels as a Source of Valuable Secondary Metabolites.** *2nd Symposium on Horticulture in Europe*, Angers France, July 1st -5, 2012, *Book of Abstracts*: 122;

- **Šmit Z., Tartari F., Stamati F., Vevečka Priftaj A., Isteni J. Analysis of Roman glass from Albania by PIXE-PIGE method,** *Nuclear Instruments and Methods in Physics Research, B*, on-line (journal homepage www.elsevier.com/locate/nimb), and in the Journal "Nuclear Instruments and Methods in Physics Research B", 296 (2013): 7–13;

- **Sota (Mata) V., Kongjika E., In vitro propagation of plantlets of wild pear (Pyrus pyraeaster L.) using shoot tips as primary explants.** *International Conference of Ecosystems (ICE)*. Tirana, Albania, June 4 – 6, 2012. *Abstract Book: Essays on Ecosystem and Environment Research*. ISBN 978-9928-4068-0-4, p. 36.

- **Sota V., Kongjika E., Slow growth in vitro conservation of Zizyphus jujuba Mill.,** *International Conference: Role of Research in Sustainable Development of Agriculture and Rural Areas*. Organizer: Biotechnical Faculty, University of Montenegro Podgorica, May 23 – 26, 2012, Podgorica, Montenegro. *Book of Abstracts*: p. 127;

- Vitaku A., Baruti B., Malollari I., *Impact of heavy toxic compounds on a complex pollution caused by mining and metallurgical wastes in Trepça, Kosovo*, *Journal of Environmental Protection and Ecology*, 2012, 13(1): 96-104, <http://www.jepe-journal.info/journal-content>;

- Xhagolli L., Malollari I., Bacu A., Koraj Dh., Manaj H., Dhroso A., Uku S., *Study of enzymes impact on beer filterability*, *XXII Congress of Chemists and Technologists of Macedonia*. OHRID, Macedonia, Sept. 05 – 09, 2012, *Book of Abstract*: 145, ISBN 978-9989-760-11-2.

Të dhënat gjatë vitit 2012, tregojnë përsëri dukshëm se ekziston shpërpjestimi midis numrit të artikujve të publikuar brenda vendit, me ata jashtë vendit; megjithatë, vazhdon të shfaqet tendenca e akademikëve për të botuar jashtë vendit për shkak të pabarazisë gjatë procesit të vleftësimit të tyre gjatë proceseve të kualifikimit (këshillave të profesorëve e KVTA), si dhe kapacitetit të ulët të botimeve shkencore në Shqipëri, krahasuar me nevojat e stafit akademik për përhapjen e rezultateve të kërkimit dhe mangësitë e revistave shkencore me faktor impakti.

D. Artikuj dhe intervista në media

Për probleme të aplikimit të shkencave natyrore-teknike, shumë akademikë kanë dhënë opinionet e tyre ideore, aplikative dhe vizione për problemet shqetësuese të ekonomisë së vendit, zhvillimin e arsimit, të kërkimit shkencor, e problematikave të shumta sociale. Problemet e shkencave të natyrës gjithmonë e më shumë janë tashmë në vëmendjen e opinionit publik për domosdoshmëri të zgjidhjes së problemeve ekonomike të vendit.




Fig.14. Harta e shpërndarjes së botimeve

IV. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Bashkëpunimi me universitetet shqiptare përbën një drejtim kryesor të aktivitetit shkencor dhe didaktik të Akademisë së Shkencave. Në përputhje me misionin e saj, AShSh bashkëpunon me institucione kërkimore dhe mësimore, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme fizike për kërkim, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës, brenda dhe jashtë vendit. Marrëdhëniet që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjeve në fusha të rëndësishme të bashkëpunimit, kanë bërë të mundur pjesëmarrjen në vazhdimësi të anëtarëve të Akademisë në proceset mësimdhënëse, si dhe në projekte shkencore të përbashkëta me departamentet dhe grupet shumëdisiplinore kërkimore shkencore të universiteteve.

Në vazhdimësi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë kontribuon në zhvillimin e procesit mësimor e shkencor dhe në bashkëpunim me universitete shqipfolëse jashtë vendit me objektiv mbajtjen e leksioneve, bashkëpunimin për ideimin dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore dhe arsimore, pjesëmarrjen në programet e Bashkimit Europian, veprimtari të përbashkëta promovimi dhe publikimi, zhvillimin e konferencave shkencore të përbashkëta etj., bazuar këto në marrëveshjet e ASh-së me to.

Një rëndësi të veçantë kanë marrë gjithnjë e më tepër veprimtaritë që lidhen me marrëdhëniet e AShSh-së në planin kombëtar. Akademia e Shkencave, bazuar në pozicionin e saj në sistemin e kërkimit shkencor të vendit, ka lidhje organike me shumë institucione të tjera, me të cilat ka bashkërendim të programuar e jo

rastësor për realizimin e objektivave të saj. Për këtë qëllim, AShSh, si institucion elitari shkencor buxhetor, i detyrohet shoqërisë të jetë eksperte dhe këshilluese në fusha të ndryshme. AShSh ka lidhje dhe bashkëpunon ngushtë me MASH, AKTI e institucione të tjera dhe ka një rol të veçantë në zhvillimin e ndërsjellë akademi – universitete - biznes – shoqëri civile.

Shumica e anëtarëve të AShSh-së janë punonjës efektivë dhe drejtues të universiteteve, të fakulteteve dhe departamenteve të ndryshme, veçanërisht të atyre publike dhe bëjnë një jetë shumë aktive në gjirin e këtyre universiteteve. Anëtarët e AShSh-së me kualifikim shumë të lartë, kanë marrë pjesë aktive në mësimdhënie për zbatimin me cilësi të procesit të Bolonjës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Ata janë titullarë të lëndëve themelore dhe atyre bashkëkohore për të gjitha nivelet e organizimit; janë ligjërues të leksioneve për probleme të specializuara dhe që kërkojnë një kualifikim të lartë dhe organizues të kurseve speciale. Gjitashtu ata janë pjesëmarrës në projekte të përbashkëta shkencore. Pjesa më e madhe e projekteve shkencore të iniciuara nga AShSh në nivel kombëtar dhe europian realizohet me partnerë nga UT, UPT dhe UBT, veçanërisht në kushtet e tanishme kur AShSh nuk ka institutet e veta kërkimore shkencore. Në disa raste specifike, bashkëpunëtorët në universitete janë dhe koordinatorë të projekteve të përbashkëta; organizues të konferencave ndërkombëtare me komitete të përbashkëta shkencore dhe organizative, për probleme me interes (si menaxhimi i pyjeve në Shqipëri dhe Kosovë; probleme të përdorimit të metodave bioteknologjike në bujqësi, mjekësi, mjedis, për sigurinë ushqimore; probleme të zbatimit të metodave kimike në zhvillimin aktual të vendit; probleme të ruajtjes dhe shfrytëzimit të biodiversitetit, etj.); hartues të përbashkët të veprave shkencore (monografi, fjalorë shpjegues etj.), që u vlejnë studentëve të niveleve të larta të kualifikimit; ligjërues shkencorë dhe promovues të veprave shkencore didaktike me vlerë dhe për studentët e niveleve të ndryshme. Në këto veprimtari të organizuara nga seksionet kanë marrë pjesë dhe kolegë nga universitete të ndryshme (shtetërore e private) dhe studentë; anëtarë të këshillave të profesorëve, jurive e komisioneve të kualifikimit, bordeve të institucioneve të arsimit dhe grupeve *ad hoc* të punës për legjisllacionin, etj., në sistemin universitar e shkencor; udhëheqës të diplomave, masterave dhe doktoraturave; hartues të kurrikulave, programeve etj.; pjesëmarrës në hartimin e teksteve të nivelit parauniversitar në kushtet e liberalizimit të teksteve shkollore, si përparësi e

MASH-it, veçanërisht në fazën e tanishme kur është vërejtur një tendencë e theksuar subjektivizmi. Si pjesëmarrja në autorësi, ashtu dhe oponenta e kualifikuar e personelit akademik për tekstet e në fusha të ndryshme, synon drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së procesit mësimor me tendencë afrimin në nivelet europiane të shkollës shqiptare në të gjitha nivelet.

Grafiku i mëposhtëm paraqet përfshirjen e anëtarëve të Akademisë në procesin mësimor të arsimit të lartë.

Pothuajse të gjithë "Akademikët" dhe "Akademikët e asociuar" të seksioneve, janë të angazhuar në veprimtarinë pedagogjike duke mbajtur kurse sistematike, kurse speciale, seminare dhe udhëheqje shkencore në fakultetet përkatëse.

Rezulton se nga 41 anëtarë "Akademikë të rregullt", të Asamblesë, 4 janë në moshën 45-54 vjeç; 17 janë 55-64 vjeç dhe 20 janë mbi 65 vjeç.

Disa të dhëna për aktivitetin mësimor sipas seksioneve përmbledhtazi mund të renditen në vijim.

SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQERORE DHE ALBANOLOGJIKE

A. Leksione:

- **Kolec Topalli**, leksione "Fonetika historike", në MND dhe doktoraturë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (QSA);

- **Kolec Topalli**, leksione "Gramatika historike", në MND dhe doktoraturë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (QSA);

- **Ethem Likaj**, leksione "Gramatikë historike e gjuhës shqipe", në ciklin e dytë të studimeve për "Master Shkencor";

- **Ethem Likaj**, leksione "Morfologji teorike e gjuhës shqipe", në ciklin e dytë të studimeve për "Master Shkencor";

- **Ethem Likaj**, leksione "Probleme teorike të shqipes", në ciklin e tretë të studimeve për "Doktoraturë";

- **Ethem Likaj**, leksione "Morfologji e shqipes", me studentë të vitit të II;

- **Marenglen Verli**, leksione "Historia e popullit shqiptar në shek. XX", Fakulteti Histori-Filologji dhe Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Shkolla doktorale pranë (QSA);

- **Gjovalin Shkurtaç**, leksione "Dialektologji", në MND, SHD, Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Gjirokastrës, Universiteti i Korçës;
- **Gjovalin Shkurtaç**, leksione "Kultura e gjuhës shqipe", Albanian University, Tiranë;
- **Jorgo Bulo**, "Naim Frashëri dhe sistemi letrar shqiptar", ligjërata pasuniversitare në Fakultetin Histori-Filologji;
- **Anastas Angjeli**, Gjatë gjithë vitit drejton procesin mësimor universitar e pasuniversitar si rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë si dhe Lektor i lëndës "Financat ndërkombëtare" dhe "Financat Publike";
- **Kosta Barjaba**, lektor i "Sociologjisë", Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë;
- **Kosta Barjaba**, lektor i "Administrim publik", Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë;
- **Kosta Barjaba**, lektor i "Njohuri të thelluara për grupet dhe institucionet e shoqërisë", MND, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë;
- **Kosta Barjaba**, lektor i "Teorisë së demokracisë dhe integritetit evropian", Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë;
- **Kosta Barjaba**, lektor i ftuar (nga Prof. Luigi Perrone) "*Sociologjia e migracionit dhe e proceseve kulturore*", Universiteti i Salentos, Itali.

B. Drejtues në: Doktoraturë dhe Master

Gjatë vitit 2012 ka ardhur duke u zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimi me universitetet dhe katedrat përkatëse, si dhe kontributi i akademikëve për udhëheqjen shkencore të masterave dhe doktoraturave. Midis tyre mund të përmendim:

- **Ethem Likaj**. Udhëheqje doktorature me temë "Raporte të paskajores me lidhoren në gjuhën shqipe dhe në gjuhën gjermane", Tiranë, 2012;
- **Ethem Likaj**. Udhëheqje doktorature me temë "Gjuha e sotme shqipe e re greke: fjalori, ndryshimet morfologjike dhe vështirësitë që ndeshin nxënësit shqiptarë në mësimin e gjuhës greke", Tiranë, 2012;

- **Ethem Likaj.** Udhëheqje doktorature me temë "Fjalët e përbëra në Fjalorin e gjuhës shqipe dhe përgjegjëset e tyre në gjuhën gjermane", Tiranë, 2012;
- **Ethem Likaj.** Udhëheqje doktorature me temë "Lidhja dhe paskajorja në gjuhën shqipe dhe turke", Tiranë, 2012;
- **Ethem Likaj.** Udhëheqje doktorature me temë "Kompozitat e shqipes dhe të gjuhës angleze në fjalorët përkatës", (në proces);
- **Ethem Likaj.** Udhëheqje doktorature me temë "Mbi zbatimin praktik të normave morfologjike të shqipes standarde në shkollë", (në proces);
- **Gjovalin Shkurtaç.** Udhëheqje doktorature me temë nga fusha e Sociolinguistikës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, nga Adriatik Derjaj, qershor 2012;
- **Gjovalin Shkurtaç.** Udhëheqje doktorature me temë nga fusha e dialektologjisë "E folmja e Rahovecit me rrethinë", nga Frederik Dulaj, QSA, qershor 2012;
- **Jorgo Bullo.** Oponent për tezën e doktoraturës "Poezia e Fishtës" të disertantes Lili Sula, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë, korrik 2012.
- **Floresha Dado,** është lektore në disa lëndë në fushën e letërsisë në Fakultetin Histori-Filologji, si dhe udhëheq disa studentë në maste e doktorature.
- **Artan Fuga,** zhvillon në disa kurse leksione në UT;

Edhe akademikë të tjerë janë të përfshirë në procesin akademik në fushat e tyre përkatëse, në udhëheqje të një numri të konsiderueshëm studentësh në studimet master e doktoraturë.

SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

A. Leksione:

- **Frashëri N.** Leksione "*Kriptografia*" Departamenti Inxhinieri Informatike (Msc), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, UPT;
- **Frashëri N.** Leksione "*Programimi në mjedisë të shpërndara*" Departamenti Inxhinieri Informatike (Bsc), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, UPT;
- **Frashëri N.** Leksione "*Sistemet e shfrytëzimit*", Departamenti i Informatikës (Bsc), Fakulteti Ekonomik, UT;

- **Frashëri N.** Leksione “*Sistemet paralele dhe të shpërndara*”, Departamenti i Informatikës (Msc), Fakulteti Ekonomik;
- **Gruda N.** Technische Universität Berlin: Organizues e ligjërues i modulit “*Produktqualität von Obst und Gemüse*” (MSc, studentë të vitit të parë e të dytë);
- **Gruda N.** Universität Bonn: Bashkëligjërues në modulën “*Horticultural Production Systems*” (MSc, studentë të vitit të parë e të dytë);
- **Gruda N.** Universität Bonn: Bashkëligjërues në modulën “*Ringvorlesung Grundnahrungsmittel*” (BSc, studentë të vitit të parë);
- **Gruda N.** Universität Bonn: Bashkëligjërues në modulën “*Anbau und Physiologie der Sonderkulturen*” (BSc, studentë të vitit të tretë);
- **Gruda N.** Universität Bonn: Bashkëligjërues në modulën “*Anbau, Ertragsbildung und Ertragsfaktoren landwirtschaftlicher und gärtnerischer Kulturpflanzen*” (BSc, studentë të vitit të tretë).
- **Haxhimihali Dh.**, Leksione në kursin “*Bazat e industrisë kimike*”, Departamenti i Kimisë Industriale, kursi II, FShN, UT;
- **Kongjika E.**, Leksione “*Bioenergjetika*”, Master Shkencor, Bioteknologji Molekulare dhe Industriale, Departamenti i Bioteknologjisë, FShN;
- **Kongjika E.** Leksione “*Kulturat Qelizore & Indore*”, Master Shkencor dhe Master Profesional, Bioteknologji Molekulare dhe Industriale, Departamenti i Bioteknologjisë, FShN;
- **Malollari I.** Leksione në programin Master Shkencor: “*Inxhinieria e Reaksioneve Kimike*” (UT, FShN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Malollari I.** Leksione në programin Master Shkencor: “*Projektimi në Inxhinierinë Kimike*” (UT, FShN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Malollari I.** Leksione në programin Master Shkencor: “*Modelimi dhe Optimizimi i Proceseve*” (UT, FShN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Malollari I.** Leksione në programin Master Shkencor: “*Modelimi fizik dhe matematik i Proceseve*” (UT, FShN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Malollari I.** Leksione në programin Master Shkencor: “*Njohuri të Inxhinierisë Kimike*” (UT, FShN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Merkoçi A.** Leksione “*Biosensorët e bazuar në nanomateriale*” në kurset e Doktoratës të Universitetit Autonom të Barcelonës;
- **Resuli B.** Leksione në lëndën “*Gastrohepatologjia*” dhe me shkollën e specializimit në *Gastrohepatologji*, (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Veveçka (Priftaj) A.** Titullare dhe hartuese e lëndës në shkollën e Doktoraturës "Fizika e Materialeve", (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);
- **Vila F.** Leksione në ciklet universitare: (cikli I) *Fizika Moderne*, (UT, FShN, Departamenti i Fizikës);
- **Vila F.** Leksione në ciklet universitare: (cikli II) *Bazat e Optikës, Plotësime të Fizikës, Probleme të Fizikës Moderne, Metoda zgjidhjeje të problemave të Fizikës*, (UT, FShN, Departamenti i Fizikës);

B. Drejtues Doktoratash dhe Masterash

- **Bushati S.** Udhëheqje masteri "*Aplikimi i sizmikës refraktuese në studimet gjeoteknike të kompleksit hidroenergjetik të Devollit*", nga Erald Silo, (Fakulteti Gjeologji-Miniera, UPT);
- **Bushati S.** Udhëheqje dokrorature "*Valët sizmike sipërfaqësore dhe aplikimi i tyre*", nga Erald Silo, 2012-vazhdim (Fakulteti Gjeologji-Miniera, UPT);
- **Frashëri N.** Udhëheqje temash Msc, si dhe tri udhëheqje doktorate;
- **Haxhimihali Dh.** Udhëheqje doktorate "*Studimi i çështjeve të prodhimit të pastër në proceset e prodhimit të pijeve joalkoolike me ambalazhe plastike*" nga Msc. E. Halluni, 2011- në vazhdim (UT, FSHN, Departamenti i Kimisë Industriale);
- **Kongjika E.,** Abdullai K. Udhëheqje doktorate "*Karakterizimi biomorfologjik, fiziologjik dhe ruajtja "ex situ" e gjermoplazmës së specieve të "ringjalljes" së gjinisë Ramonda në Kosovë dhe Maqedoni*" nga MSc. Bekim Gashi 2011 - 2013, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë);
- **Kongjika E.,** Bacu A. Udhëheqje doktorate "*Shëndetësimi in vitro i fidaneve të disa kultivarëve të mollës (Malus domestica borkh.) të rrethit të Korçës me anë të kulturës së meristemës dhe kontrolli fitosanitar i tyre*" nga MSc. Marinela Grazhdani (Xeka) 2011 - 2014, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë);
- **Kongjika E.,** Zekaj Zh. Udhëheqje doktorate "*Ruajtja e gjermoplazmës së specieve frutore spontane shqiptare të rrezikuara për zhdukje dhe me vlera ekonomike me metoda të ndryshme të konservimit in vitro*" nga Msc. Valbona Sota, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë), mbrojtur 2012;
- **Kongjika E.,** Udhëheqje masteri, "*Efekti i gjenotipit, eksplantit dhe terrenit ushqyes në rigjenerimin in vitro të shegës, Punica granatum L.*" nga Enea Alimllari, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2012 – 2013;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Krahasimi i llojeve të ndryshme të organogjenezës në kulturën in vitro të bimës së kiwit (Actinidia spp.)*.” nga Eni Dengo, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2011 – 2012; mbrojtur në korrik 2012;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Krahasimi i organogjenezes direkte dhe indirekte në mikroshumimin e species endemike Forsythia europea Degen et Bald. (boshtra) (popullata e zonës së Mirditës)*” nga Aida Kaçorri, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2012 – 2013;

- **Kongjika E.**, Udhëheqje masteri, “*Kultura e meristemës së disa kultivarëve të dardhës (Pyrus communis L.) të zonës së Shqipërisë së Mesme*” nga Olsion Lama, (UT, FSHN, Departamenti i Bioteknologjisë) 2011 – 2012; mbrojtur në korrik 2012;

- **Merkoçi A.**, Udhëheqje shkencore të doktoratës së 5 kandidatëve: Claudio Parolo, Maria Guix, Adaris Lopez, Helena Monton, Mariana Medina (Instituti Katalan i Nanoteknologjisë, Spanjë);

- **Petro P.**, Udhëheqje doktrate në fushën e Algjibrës (Teoria e Gjysmëgrupeve dhe Teoria e Unazave), (UT, FSHN, Departamenti i Matematikës);

- **Petro P.**, Udhëheqje masteri “Gjysmëgrupet e thjeshtë dhe zero të thjeshtë” (UT, FSHN, Departamenti i Matematikës);

- **Petro P.**, Udhëheqje masteri “Struktura algjebrike të numrave të plotë sipas modulit p” (FSHN, Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan);

- **Resuli B.**, Udhëheqje doktrate “*Hepatiti C në të hemodializuarit*” (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Resuli B.**, Udhëheqje doktrate “*Insulino-resistenca periferike në të sëmurët me hepatit kronik C*” (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Resuli B.**, Udhëheqje doktrate “*Ndërlikimet madhore kërcënuese të sëmundjes alkoolike të mëlçisë*” (tetor 2012) (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Resuli B.**, Udhëheqje doktrate “*Prekja e mëlçisë në të sëmurët me diabet*” (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Resuli B.**, Udhëheqje doktrate “*Steatohepatiti në fëmijët obezë të Tiranës*” (UT, Fakulteti i Mjekësisë);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktrature “*Metodat e imtësimit të kokrrizave të materialeve metalike*”, (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktrate “*Studimi i vetive të materialeve nanostrukturore të përftuara me anë të Deformimit të Fortë Plastik*” (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje doktrate “*Vlerësimi i kompozicionit trupor dhe ndikimi i stërvitjes proprioceptive në parametrat biomekanikë, në grupmosha të ndryshme*” (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Veveçka (Priftaj) A.**, Udhëheqje në Master Shkencor “*Metodat e matjes së fortësisë së materialeve*”, (UPT, Departamenti i Fizikës Inxhinierike);

- **Vila F.**, Udhëheqje doktrate “*Studim mbi elementet themelore dhe parametrat e tyre specifike që ndikojnë në elektrizimin e atmosferës*” me doktorant Florian Mandija, pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (mbrojtur 2012);

- **Vila F.**, Udhëheqje doktrate “*Studim mbi ngarkimin elektrostatik të aerosoleve atmosferike dhe bashkëveprimin jon aerosol*” me doktorant Edmond Lukaj, fizikant, pedagog i jashtëm (Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër)

- **Vila F.**, Udhëheqje doktrate “*Studim mbi trajtimin teorik-eksperimental të fizikës në shkollën e Mesme*” me doktorant Alion Alizoti, pedagog (UT, FShN, Departamenti i Fizikës);




Fig. 15. Përfshirja në procesin mësimor

Veprimtaritë e realizuara nga AShSh, përditë e më tepër realizojnë qëllimin që ajo ka në përputhje me misionin e saj, që të jetë jo vetëm *shtëpia e përbashkët* e akademikëve, por e të gjithë komunitetit shkencor shqiptar brenda e jashtë vendit; gjithashtu ajo është e hapur për një bashkëpunim me shkollarët e brezave të

ndryshëm, shoqërinë civile, me biznesin si dhe me të gjithë të interesuarit për kërkim e dije.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e anëtarëve të Akademisë në takime të ndryshme ndërkombëtare, nëpërmjet lidhjeve me institucione kërkimore-shkencore e komunitetin shkencor në përgjithësi, brenda e jashtë vendit, ka luajtur një rol të rëndësishëm në kualifikimin shkencor, informimin, nxitjen në bashkëhartimin e veprimtarive në shërbim të komunitetit shkencor brenda vendit. Akademia ka ndjekur me vëmendje edhe veprimtaritë e shkencëtarëve në përgjithësi, e atyre të rinj, në veçanti jashtë vendit, duke u bërë përçuese e dijeve, me synim transferimin e tyre në kontribute për kërkim e zhvillim në Shqipëri. Kualifikimi shkencor i kërkuesve të rinj do të vazhdojë të jetë përparësi edhe në programet zhvillimore të AShSh-së.

VEPRIMTARITË E SEKTORËVE MBËSHTETËS

I. NJËSIA E PROJEKTEVE TË KËRKIMIT, ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK DHE INOVACIONEVE

Bashkëpunimi industri-akademi përcaktohet si një ndërveprim dhe bashkëpunim i rëndësishëm midis faktorëve si biznesi, institutet dhe universitetet, në proceset e nxitjes së projekteve shumëdisiplinore përfshirë K&Zh, trajnimin dhe edukimin e burimeve njerëzore dhe këmbimin e ideve dhe informacionit, të cilin AShSH e ka realizuar nëpërmjet NjPKZhl në bashkëpunim me seksionet e shkencave. NjPKZhl ka synuar të bëjë realitet që produkti shkencor i Akademisë, e në përgjithësi ai i sistemit të kërkimit shkencor, të jetë pjesë përbërëse e arsimit të lartë duke synuar të sjellë përgjigje për problematikat e prodhimit e zhvillimit të vendit. Ajo ka ideuar, aplikuar, koordinuar e menaxhuar projekte duke shërbyer edhe si nyje informative e K&Zh, duke krijuar e zgjeruar lidhje me institucione të tjera. Duhet veçuar kontaktet e përhershme dhe shkëmbimi i informacionit me Euro Fund, WBC-INCO.NET, REC, GED, UNDP, etj., për kërkimin shkencor.

AShSh në bashkëpunim me IGJEUM, UPT po zhvillon projektin mbi sistemin ujqor të liqenit të Shkodrës, i cili është një projekt madhor që zhvillohet në kuadër të Programit IPA ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi (2012-2014).

II. DEGA EKONOMIKE

Bazuar në analizën e buxhetit të AShSh-së, për vitin 2012, po paraqesim realizimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale, duke krahasuar treguesit e buxhetit të miratuar për këtë periudhë, me ata faktikë. Monitorimi është mbështetur në raportimin e Akademisë së Shkencave, për realizimin e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2012.

Akademia e Shkencave menaxhoi fondet buxhetore të vitit 2012, në kuadër të programit "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi.

Nga ana e AShSh-së janë bërë përpjekje të vazhdueshme për uljen në minimum të shpenzimeve. Akademia e Shkencave me fondet në dispozicion, e ka pasur shumë të vështirë të përballojë realizimin e detyrave të saj.

Ajo ka botuar një numër të konsiderueshëm veprash shkencore, monografi e periodikë (shih botimet e seksioneve), prej nga ka lindur edhe detyrimi i pagesave të honorareve për autorët e veprave shkencore (në zbatim të VKM 120 dt. 27.1.1997), të papaguara që nga vitet e mëparshme dhe janë bërë përpjekjet maksimale për realizime edhe në këtë drejtim.

Gjithashtu, Akademia e Shkencave gjatë vitit 2012 ka përballuar zhvillimin e veprimtarive, konferencave shkencore ndërkombëtare e botimeve, në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë si dhe ato në kuadër të 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Monitorimi i shpenzimeve të Akademisë së Shkencave për vitin 2012 është realizuar sipas ligjit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Ai është mbështetur në raportimin e Akademisë së Shkencave për realizimin e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2012 dhe është kryer në bazë të menaxhimit të fondeve buxhetore të vitit 2012 në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi".

Realizimi i shpenzimeve krahasuar me planin vjetor të miratuar paraqitet si vijon:

Pasqyra 1. Realizimi i buxhetit sipas zërave

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti Vjetor 2012	Fakti vitit 2012	Në %
1	Paga (600)	25,431	25,423	100
2	Sigurime shoqërore (601)	3,508	3,505	100
3	Shpenzime korente (602)	14,583	14,583	100
4	Transferta të brendshme (604)	39	39	100
5	Transferta me jashtë (605)	151	151	100
6	Transferime të brendshme (606)	33,075	33,070	100
7	Investime (231)	1,000	860	86
Totali i shpenzimeve		77,783	77,631	

Shpenzimet faktike krahasuar me fondet e buxhetit për vitin 2012:

- Artikulli 600 është realizuar 100%;
- Artikulli 601 është realizuar 100%;
- Në artikullin 602 realizimi i fondeve është 100%;
- Për artikullin 604 (shpenzime për Kosovën) sipas protokoll-marrëveshjeve të lidhura, këto fonde janë realizuar 100%;
 - Në artikullin 605, pagesat e kuotave të anëtarësisë të organizatave ndërkombëtare, në të cilat aderon institucioni ynë, janë realizuar 100%;
- Artikulli 606 është realizuar në masën 100%;
- Në zërin 231 realizimi i fondeve është 86%.

Shpenzimet me fondet e buxhetit sipas limiteve të miratuara u realizuan 100 përqind sipas pasqyrës së mëposhtme.

Pasqyra 2. Niveli i realizimit të shpenzimeve në total

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Fondi limit viti 2012	Fakti viti 2012	Në %
1	600-601	28939	28928	
2	602-606	47848	47843	
	Totali i shpenzimeve	76787	76771	

Përfundimi kryesor që nxirret nga një analizë e thjeshtë e këtyre pasqyrave është se niveli i realizimit të shpenzimeve në total për vitin 2012, në krahasim me fondet e vëna në dispozicion për këtë periudhë arriti në 100 përqind.

III. DEGA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, ka krijuar në kohë të gjitha lehtësitë dhe procedurat për të siguruar një partneritet serioz me të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe ato të vendit, me të cilat ASH bashkëpunon. Gjithashtu, ajo ka mbështetur pjesëmarrjen e anëtarëve të ASHSh-së në aktivitete të ndryshme si: kongrese, konferenca, seminare, takime protokollare, takime të ndërsjella, takime në ASH dhe marrëdhënie me mediat, për të cilat jepet informacion i hollësishëm në *Shtojcën 2*.

Gjithashtu DMJP, në përputhje me funksionet e saj, ka kontribuar në marrëdhëniet e ASH me institucionet qeverisëse (MPJ, MASH etj.), organizmat ndërkombëtarë në vend dhe me publikun.

IV. BIBLIOTEKA SHKENCORE

Biblioteka Shkencore e Akademisë këtë vit është përballuar me sfida të vërteta, si përse u përket zhvillimeve teknologjike dhe funksionimit të bibliotekës, por sidomos realizimit të një projekti me rreze të gjerë, që jo vetëm përfshinte të gjithë stafin e vogël të kësaj biblioteke dhe lexuesit tanë, por në radhë të parë posaçërisht për faktin që kjo bibliotekë luajti rolin e koordinatorit dhe të trajnuesit për të gjithë komunitetin shkencor të vendit në qasjen apo aksesin në burimet elektronike të ofruara nga Projekti ERA 2012 (shih kapitullin mbi projektet).

Për të realizuar këtë projekt janë organizuar me koordinator kryesor stafin e Bibliotekës, dy konferenca kombëtare, ku kanë marrë pjesë rreth 100 persona, punonjës të fushës, por edhe vendimmarrës nga universitetet publike dhe private.

Konferencat e organizuara janë:

1. Konferenca kombëtare "Burimet elektronike për Shqipërinë sot dhe nesër", organizuar më 6 dhjetor 2012.

Qëllimi i konferencës ishte: rritja e ndërgjegjësimit të përdoruesve në rëndësinë e burimeve elektronike ndërkombëtare në mbështetje të edukimit, kërkimit dhe zhvillimit të përgjithshëm, si edhe rritja e nivelit të informacionit të vendimmarrësit kryesorë për disponueshmërinë e burimeve elektronike dhe për rëndësinë e planifikimit të mjeteve të domosdoshme financiare në vitet që do të vijnë.

Në konferencë morën pjesë të paktën 100 veta, përfaqësues të institucioneve kërkimore dhe edukative (rektorë/zv.rektorë, dekanë dhe drejtues të grupeve të kërkimeve shkencore), drejtorë të bibliotekave dhe bibliotekarë përgjegjës për burimet elektronike, përfaqësues të ministrive dhe agjencive përgjegjëse për zhvillimin e infrastrukturës së informacionit publik të shkencës, edukimit dhe kulturës. Morën pjesë edhe partnerët e këtij projekti, përfaqësues të IZUM, Slloveni dhe përfaqësues të burimeve elektronike më të rëndësishme, si: Thomson Reuters, Proquest, EBSCO, WHO, të cilët prezantuan bazat e të dhënave të tyre, si dhe këmbëngulën në vazhdimin e shfrytëzimit të këtyre burimeve elektronike shkencore me vlera të mëdha.

Në konferencë, referati kryesor *Hendeku mes ofertës dhe kërkesës në shfrytëzimin e burimeve elektronike në Shqipëri*, mbajtur nga përgjegjësja e bibliotekës, Dr. Mariana Ymeri, vuri në dukje jo vetëm përparësitë e teknologjisë së informacionit sot, por edhe disa probleme që u vunë re gjatë shfrytëzimit të këtyre burimeve, probleme që kishin të bënin në radhë të parë me mosangazhimin e forcave shkencore në qasjen për këto burime. Kjo konferencë u zhvillua në dy ditë. Në ditën e dytë u organizuan takime me stafet për përditësimin e tyre rreth së ardhmes së projektit.

Në këtë konferencë u përrua gjithashtu, edhe fillimi i një projekti bibliografik që lidhet me hartimin e rekordeve bibliografike për veprimtarinë shkencore të kërkuesve shkencorë në vend. Disa shembuj hartimi të këtij tipi bibliografie u dhanë në referimin e Mirlona Buzos, e cila është marrë me hartimin e një bibliografie të stafit shkencor të Universitetit Publik Mjekësor në Tiranë.

2. Konferenca “Tendencat dhe zhvillimet në mjedisin global të bibliotekave”, organizuar më 9 Maj 2012.

Referati kryesor u mbajt nga Dr. Rein van Charldrop, përfaqësues i OCLC-së Ohio, SHBA, qendra më e rëndësishme në botë e shërbimit dhe kërkimit bibliotekar, që ofron bazën më të madhe të informacionit bibliotekar të quajtur WorldCat. Viti 2012 shënon 45 vjetorin e krijimit të kësaj organizate. Në këtë përvjetor të 45-të, WorldCat është pasuruar me më shumë se 260 milion regjistrime dhe 1.7 miliardë koleksione. Rreth 72 000 biblioteka në mbarë botën, janë anëtarë të OCLC-së. Njohja më gjerësisht me këtë organizatë, me produktet e saj (OPAC), prirjet kryesore që kanë ndikim mbi bibliotekat dhe ndihma që ofrohet nga OCCL për bibliotekat në situatën e sotme, janë qëllimet e prezantimit në Tiranë dhe më pas në Prishtinë nga ana e Dr. Rein van Charldrop.

Në konferencë morën pjesë profesionistë të kësaj fushe, nga i gjithë sistemi bibliotekar i vendit.

Gjithashtu në kuadër të projektit janë organizuar rreth 10 workshop-e, në të gjithë vendin me punonjësit e bibliotekave universitare rreth përdorimit dhe qasjes në burimet elektronike. Këto janë kryer:

- Më 18 Mars 2012 në Universitetin Politeknik të Tiranës, ku u diskutua rreth alternativave të librit elektronik dhe burimeve të përshtatshme për komunitetin shkencor të këtij universiteti;

- Më 21 mars 2012 u organizua një trajnim në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Pjesëmarrësit në workshop ishin profesorë, kërkues shkencorë, studentë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Gjithashtu mori pjesë edhe stafi i bibliotekës publike "Marin Barleti" të këtij qyteti;

- I njëjti workshop u organizua në 28 prill 2012 në Universitetin “Fan Noli”, Korçë.

- Më 29 prill 2012 u organizua një takim i tillë trajnues në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

- Më 18 maj 2012 trajnimi u krye me stafin e bibliotekës së Fakultetit të Filologjisë;

- Më 15 tetor 2012 u organizua një workshop në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë. Pjesëmarrësit në workshop ishin profesorë, kërkues shkencorë, studentë të Universitetit të Vlorës;

- Më 20 tetor, i njëjti takim është mbajtur edhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Të gjitha këto takime janë karakterizuar nga një interesim i veçantë i profesorit, që e ka vlerësuar jashtëzakonisht mundësinë që jep ky projekt

Stafi i Bibliotekës shkencore të Akademisë ka realizuar dhe detyra të tjera. Duhet pasur parasysh që, nëse flasim për pasurim të bibliotekës dhe për shfrytëzim të saj nga lexuesit, dy aspektet themelore të funksionimit të mirë të një biblioteke, viti 2012 ka qenë një vit rekord për Bibliotekën shkencore. Qindra mijëra materiale shkencore dhe mijëra lexues i janë shtuar bibliotekës sonë këtë vit.

Gjatë periudhës dhjetor 2011 dhe në vazhdim është kryer inventarizimi dhe digjitalizimi i fondit të periodikëve (rreth 50% e inventarizimit). Është parashikuar që ky inventarizim të përfundojë gjatë vitit 2013.

Me rastin e 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave dhe 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë u hartua bibliografia e botimeve të Akademisë së Shkencave. Kjo bibliografi ishte rezultat i punës së përbashkët të stafit të bibliotekës. Bibliografia përmbledh veprat më të rëndësishme të botuara nga kjo Akademi që në vitin e themelimit të saj deri në ditët tona.

Është kryer klasifikimi i librave të rinj të hyrë në bibliotekë, shqip dhe libra të huaj, botime të Akademisë së Shkencave, libra të blerë dhe libra të ardhur nga jashtë në kuadrin e shkëmbimeve ndërbibliotekare, rreth 440 tituj. Nga këto, 58 tituj janë të ardhur nga fondi i shkëmbimit, 173 të blerë dhe pjesa tjetër dhurime.

Këtë vit Biblioteka është pasuruar nga një fond i jashtëzakonshëm për nga vlerat dhe numri i vëllimeve, rreth 2000 tituj të dhuruar nga Fondacioni i Trashëgimisë Shqiptare (Albanian Heritage Foundation), tituj të cilat ende nuk janë inventarizuar, çka do të përbëjë sfidën më të madhe për vitin 2013.

Gjithashtu këtë vit u dhurua nga një person privat në Itali një bibliotekë e pasur mjekësore-filozofike, e cila është në përpunim e sipër.

Janë kryer gjithashtu të gjitha detyrat si skedimi i librave të rinj dhe regjistrimi i tyre në bazën e të dhënave; përgatitja e skedave topografike për librat e rinj; redaktimi i herëpashershëm i bazës së të dhënave dhe i skedarëve të bibliotekës; asistencë bibliografike dhe referencash, kryesisht për kërkues shkencorë, që kryejnë masterin në shkencat albanologjike; përgatitja e Buletinit të hyrjeve të reja, libri shqip dhe libri i huaj, shpërndarë *online* në rreth 200 adresa kërkuesish

shkencorë dhe lexuesish, me qëllim informimin e tyre për pasurimin e BSH me tituj të rinj; përgatitja e pakove për shkëmbimet jashtë vendit. etj.

Përfshirja e stafit në mësimdhënie dhe veprimtari shkencore

Përveç punës së përditshme, që lidhet me detyrat e përgjegjësitet të Bibliotekës, drejtuesja e BA, Mariana Ymeri ka mbajtur peshën kryesore në procedimin dhe mbarëvajtjen e Projektit ERA, si organizatore konferencash, ku ka mbajtur dy referatet kryesore, dhe njëherazi si trajnuese. Gjithashtu, është edhe drejtuese e masterit të editorisë në Fakultetin e Filologjisë. Këtë vit ajo ka qenë drejtuese e dy temave vjetore të studentëve të masterit, kryesisht me argumente nga gjuha standarde, probleme të saj dhe terminologjia.

Gjatë vitit 2012, kulturës shqiptare iu shtua një titull me shumë vlerë, *Përzgjedhje midis alternativave në standardizimin e gjuhës, Rasti i shqipes*, të autores Janet Byron, përkthyer nga Mariana Ymeri

Sabina Prifti, klasifikuese në këtë bibliotekë që në fillim të vitit 2011, është angazhuar në kursin dy-vjeçar të kualifikimit në shkollën e Bibliotekonomisë pranë Bibliotekës Kombëtare. Ajo ka marrë pjesë në Konferencën “Identitet kulturor shqiptar në 100 vjet pavarësi” të organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, me kumtesën “Identitet kombëtar në ceremonialin e dasmës tiranase”, si dhe ka botuar në revistën “Gjurmime Albanologjike” një artikull me temë: “Zakone e rite mortore në zonën e Tiranës dhe rrethinat e saj”

V. NJËSIA E BOTIMEVE

Njësia e Botimeve gjatë vitit 2012 ka mbështetur dhe kryer gjithë procesin e botimeve të Akademisë, të autorëve të ndryshëm (Akademikë) dhe të redaksive të dy seksioneve me revistat e tyre përkatëse, *Studia Albanica* për Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe *Albanian Journal Natural and Technical Sciences (AJNTS)* për Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike. Në të njëjtën kohë, kjo njësi përgatiti edhe të gjitha materialet e konferencave që zhvilloi Akademia e Shkencave (ftesa, postera, programe, banera etj.).

Gjatë vitit 2012 vazhdoi botimi i organeve periodike të ASh (revista shkencore):

1. *AJNTS* 32/2012

2. *AJNTS* 33/2012
3. *Studia Albanica* 1/2012
4. *Studia Albanica* 2/2012

VI. FUQIZIMI I INFRASTRUKTURËS, TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Fuqizimi i infrastrukturës, teknologjive të informacionit dhe komunikimit në Akademinë e Shkencave ka qenë një nga përparësitë kryesore të këtij viti. Veprimtaritë më të rëndësishme në këtë drejtim gjatë vitit 2012 kanë qenë:

Në kuadër të projektit ERA-2012, nga ZIT në bashkëpunim me BSh, është botuar në faqen zyrtare të ASH-së gjithë informacioni rreth shërbimeve informative dhe fuqizuesve të burimeve elektronike që mundëson ky projekt; lista e institucioneve që kanë akses në bazën e të dhënave ProQuest; institucioneve që kanë përfituar akses në këtë bazë të dhënash, u është siguruar asistencë teknike lidhur me aksesimin dhe përdorimin e kësaj baze të dhënash.

Fuqizimi i Akademisë së Shkencave dhe forcimi i rolit të saj, do të ketë impakt brenda dhe jashtë vendit: në vetë Akademinë e Shkencave, në bashkësinë e komunitetit shkencor, në arsim, në të gjitha nivelet e universitetet, në edukimin shkencor të brezit të ri, në qeverisjen e vendit në spektrin politiko-ekonomik, në zhvillimin ekonomik, në shoqërinë civile, në kompanitë private, shoqëritë jofitimprurëse, si dhe jashtë vendit, në rrjetin e Akademive të Europës Juglindore, InterPanelin e Akademive të Botës etj.

PËRPARËSITË E ASHSH-së PËR VITIN 2013

Akademia e Shkencave për të përmbushur misionin e saj, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik e Inovacioneve, edhe për vitin 2013 do të vazhdojë të synojë arritjen e standardeve europiane, në përmbushje të objektivave për integrimin në fushën e shkencës.

Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore të saj do të përqendrohen në rritjen e rolit të saj në: zhvillimin e vendit; bashkëpunimin me institucionet qeveritare, në identifikimin e problematikave për angazhimin e Ash-së në realizimin e objektivave të Qeverisë; këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet

politikëbërëse dhe vendimmarrëse; bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë; propozimin e fushave të reja të kërkimit e studimit në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik e social të vendit; botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor; organizimin e kongreseve dhe konferencave shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare; promovimin dhe mbështetjen e *ekselencës* për kërkuesit e rinj në shkencë në shkallë kombëtare, për të realizuar nivele të larta kërkimi dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit; dhënien e çmimeve shkencore, etj.

Vëmendje do t'u kushtohet rekomandimeve të analizave të BE, lidhur me zhvillimet e Sh&T në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjendjes së kërkimit në Shqipëri dhe masave për intensifikimin e punës për zbutjen e pikave të dobëta në Sh&T, të tilla si: (i) mbizotërimi i sektorit publik në Sh&T mbi atë privat; (ii) mungesa e integritetit ndërmjet agjendave të kërkimit dhe politikave të tjera; (iii) thithja e dobët e fondeve; (iv) përfshirja e pamjaftueshme në Sh&T të sektorit privat apo mungesa e promovimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjisë; (v) mungesa e mekanizmave nxitës për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar; (vi) zhvillimi dhe aplikimi i pamjaftueshëm i strategjive dhe ligjeve ekzistuese në Sh&T.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë në fokusin e saj do të vazhdojë të ketë orientimin e kërkimeve në problematikën shkencore me rëndësi kombëtare, për ndriçimin e traditave dhe vlerave identitare të kombit në fushë të gjuhës, historisë dhe të kulturës, vlera që na integrojnë në bashkësinë europiane me dinjitet dhe me identitetin tonë si popull me përparësi në fushën e gjuhësisë, historisë dhe ato të trashëgimisë së kulturës shpirtërore dhe materiale.

E rëndësishme është shtrirja e tri fushave të lartpërmendura të kërkimit shkencor në mbarë hapësirat shqiptare, pra për bashkëpërfshirjen potenciale të studiuesve shqiptarë dhe të huaj në trajtimin e këtyre problematikave dhe me ndihmesë këto për formimin e profesionistëve të rinj.

Përparësi e Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike për vitin 2013 do të jetë vazhdimi i punës me projektet e rëndësishme si Projekti për standardin e shqipes përmes Këshillit Akademik për Gjuhën Shqipe. Por puna e këtij këshilli varet në radhë të parë nga sigurimi i fondeve për funksionimin normal të tij. Po ashtu, do të vazhdojë puna për projekte të tjera të përbashkëta shkencore me

AShAK, të planifikuara në marrëveshjen e re të bashkëpunimit midis dy akademive.

Në fushën e botimeve do të përgatitet me përparësi në shtyp vëllimi me aktet e *Akademisë Solemne* kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë, studime të tjera që lidhen me këtë tematikë, midis tyre "Fjalori shqip-greqisht dhe greqisht-shqip" i Th. Mitkos, një nga veprat më të rëndësishme të leksikografisë shqipe gjatë Rilindjes, mbetur deri më sot e panjohur, dorëshkrim dhe e zbuluar në Arkivin e Mitkos në Aleksandri. Do të vazhdojë praktika e botimit të veprave të akademikëve, përfshirë dhe nga ata që nuk jetojnë, ndërsa do të punohet për tema të rëndësishme nga fushat e historisë (historia e shqiptarëve në shek. XX-të), në fushën e gjuhësisë, për fjalorin etimologjik të shqipes dhe studimet dialektologjike për të folmet e gegërishtes verilindore, në fushën e studimeve letrare, çështje të postmodernizmit në Shqipëri etj.

Studimet në fushat e shkencave shoqërore e albanologjike synojnë të trajtojnë si aspektet historike, ashtu dhe ato aktuale të zhvillimeve politike social-kulturore të shoqërisë shqiptare.

Ndërsa përparësitë në shkencat natyrore dhe teknike janë orientuar në fusha të tilla, si në atë të : rregullimit të regjimit ujor në liqene, lumenj e laguna; shfrytëzimit të energjisë së rinovueshme; teknologjitë e informimit e të komunikimit; shëndetësisë dhe shërbimit parësor; vlerësimit, ruajtjes dhe rehabilitimit të ekosistemeve natyrore; biodiversitetit dhe cilësisë së ushqimit; transferimit dhe aplikimit të teknologjive të reja në fusha të ndryshme e me prioritet ato të trashëgimisë kulturore, dhe të bioteknologjisë etj.

Gjithashtu do të synohet në:

- domosdoshmërinë e zhvillimit të kërkimit shkencor në funksion të zhvillimit të vendit e në arritjen e treguesve të anëtarësimit në Europë; kjo kërkon rritjen e kapaciteteve këshilluese të ASh, ndaj organeve politikëbërëse e vendimmarrëse dhe të shoqërisë civile;

- rritjen e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, realizimin e marrëveshjeve e protokolleve me institucione kërkimore shkencore e universitare si dhe paraqitjen dinjitoze të ASh-së në takime me qëllim transferimin e eksperiencave europiane e ndërkombëtare në Shqipëri në të gjitha fushat e zhvillimit;

Përprojekte të konsiderueshme do të bëhen në drejtim të pjesëmarrjes së Ash-së në Programet Kuadër të BE ose në programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia përfaqësohet si koordinator ose jep kontribut në nivel ekspertësh.

Nëpërmjet veprimtarive të saj, AShSh do të ketë në fokus të veprimtarisë së saj forcimin e ndërveprimit ndërmjet shkencës dhe biznesit, për kontributet e kësaj të fundit drejtpërdrejt në K-Zh duke e konsideruar si një motor të zhvillimit: zbatimin e produktit shkencor, teknologjik e inovativ në zhvillimin e biznesit në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) e më gjerë.

Veprimtaritë e AShSh do të zhvillohen nëpërmjet projekteve, konferencave e botimeve: monografive e periodikëve, brenda e jashtë vendit, ku janë përfshirë projekte të Këshillit të Ministrave, ato të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh–AKTI), në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI), si dhe të programeve të tjera të mbështetura nga akademitë e shkencave dhe organizmat ndërkombëtarë të tilla si: Projekti IPA, që zhvillohet ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi, si dhe projektet me përparësi në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Kërkuesit e rinj dhe edukimi në shkencë me grupmosha të ndryshme, do të vazhdojnë të përbëjnë përparësitë të AShSh-së edhe në të ardhmen, ku do të përfshihet bashkëpunimi me aktorë të mësimdhënies në të gjitha nivelet, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari të përbashkëta (projekte, konferenca, seminare, tavolina të përbashkëta, etj.).

Kontributi i biznesit në kërkim do të vazhdojë të jetë sfida e zhvillimit të sigurt e të shëndetshëm të shkencës, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në Shqipëri e që duhet kuptuar si *gjeni* i inovacionit.

Synim mjaft i rëndësishëm për vitin 2013 do të mbetet edhe botimi i veprave me vlera të veçanta shkencore të akademikëve dhe të studiuesve më në zë që kryejnë veprimtari brenda e jashtë vendit.

Me përparësitë e saj, Akademia e Shkencave synon arritje në një nga atributet kryesore të saj, prestigjin e lartë të merituar në komunitetin shkencor, shoqërinë civile e më gjerë, për të qenë forcë lëvizëse, ku ajo duhet të luajë një rol themelor për nxitjen e zhvillimit të vendit në të gjitha drejtimet; me përparësi në kërkimin

shkencor (për vënien në jetë të SKZHTI), për një cilësi të lartë në shoqërinë shqiptare, institucionet politikëbërëse e vendimmarrëse si edhe në shoqërinë civile, biznesin vendës dhe të huaj etj.

Konkretisht, do të zhvillohen veprimtaritë e poshtëshënuara:

I. Konferenca dhe Simpoziume

A. Konferencë shkencore ndërkombëtare mbi liqenet e Ohrit dhe të Prespës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë

Objektivat:

• Analiza shkencore shumëdisiplinore me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (Shqipëri, Maqedoni, Greqi) për vlerësimin e studimeve për liqenet e Ohrit dhe të Prespës;

• Sensibilizimi i të gjithë vendimmarrësve politikë, të komunitetit mbarëshkencor, të shoqërisë civile e të sipërmarrësve privatë për problemet e liqeneve të Ohrit dhe të Prespës;

• Projekt-ide dhe propozime për hartimin e planeve të veprimit për zgjidhjen e problemeve të zonës së liqeneve të Ohrit dhe të Prespës.

Produkti:

- Mbajtja e Konferencës shkencore ndërkombëtare mbi liqenet e Ohrit dhe të Prespës në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë;

- Deklaratë e përbashkët dhe memorije e studiuesve shqiptarë dhe maqedonas për hartimin e një dokumenti me rekomandime aplikative, emergjente, afatmesme e afatgjata për zonën, e cila t'i vihet në dispozicion MMPAU-së;

- Dy botime (*Libri i Abstrakteve dhe Përmbledhje e kumtesave*);

- Ngritja e një komisioni *ad hoc* për problemet e ndryshme të zonës: liqenet e Ohrit – Prespë;

- Përmirësimi i gjendjes të liqeneve të Ohrit dhe të Prespës në drejtim mjedisor, kulturor dhe turistik në të gjithë arealin: liqeni i Ohrit – Prespë.

B. Konferencë shkencore ndërkombëtare: "Kongresi i 7^{të} Ndërkombëtar i Shoqatës së Gjeofizikantëve të Ballkanit" (7-10 Tetor 2013) në Shqipëri.

Objektivat:

Objektivi kryesor i Kongresit të 7^{të} Ndërkombëtar të Shoqatës së Gjeofizikanëve të Ballkanit (BGS) është e ardhmja e shkencës së gjeofizikës. Kongresi synon të ndikojë, investojë në udhëheqësit e ardhshëm shkencorë, në inovacion, të influencojë në politikbërje duke ofruar këshilla të vlefshme shkencore dhe të vitalizojë gjeofizikën dhe mësimdhënien në këtë fushë. Gjithashtu, kongresi ka për qëllim të ofrojë zgjidhjet më të përshtatshme shkencore për problematikat e ndryshme me impakt në zhvillimin e vendit në përgjithësi. Shumë prej tematikave që do të preken janë të një natyre globale dhe kërkojnë bashkëpunim dhe në mënyrë të veçantë, kongresi do të mbështetë bashkëpunimin me shkencëtarët e rinj. Në takim do të diskutohet mbi teknologjitë e reja.

Produkti:

Inovacioni ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm. Kongresi do të sjellë prurje me vlerë kombëtare e ndërkombëtare, në transferimin e teknologjive të reja, zhvillimin e nismave inovative në zhvillimin kombëtar, rajonal e më gjerë në dobi të zhvillimit të kërkimit, arsimit të lartë e biznesit, në të mirën e shoqërisë në përgjithësi. Konferenca do të sjellë prurje të reja shkencore, të dobishme për kërkuesit e rinj.

II. Projekte në kuadër të Protokollit AShSh – AShASHAK

Do të hartohet dhe do të miratohet Marrëveshja e re e Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

1. “Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërkademik të Gjuhës Shqipe”. Bashkëpunim i vazhdueshëm midis AShAK (SGJL) dhe AShSh (SShShA, IGJL - QSA);

Objektivat:

- Do të ndërmerren studime për zhvillimet aktuale të shqipes standarde në përdorimet e saj publike, mbi bazën e të cilave Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe do të propozojë ndryshimet dhe përmirësimet në drejtshkrimin e gjuhës shqipe.

2. “Harta arkeologjike II”, projekt i përbashkët i AShAK (Muzeu i Kosovës) dhe AShSh (SShShA, IA – QSA), 2013;

Objektivat:

Ë Botimi i "**Hartës arkeologjike II**" të Kosovës me të dhënat e gërmimeve të reja.

3. Konferencë shkencore: “Bashkëpunimi ekonomik Shqipëri-Kosovë në kuadrin e integritimeve rajonale e më gjerë”, AShSh dhe AShAK, Tiranë, 2013;

Objektivat:

- Konferenca do të evidentojë gjendjen e marrëdhënieve ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe do të bëjë rekomandimet përkatëse për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

4. Konferencë shkencore: “Studime albanistike”, AShAK (SGJL) në bashkëpunim me AShSh (SShShA, QSA), Prishtinë 2013;

Objektivat:

- Në konferencë do të trajtohen rezultatet, problematika dhe orientimet e zhvillimit të studimeve në fushën e historisë, historisë së kulturës, gjuhës, arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore, në stadin aktual të shoqërisë shqiptare.

Produkti:

Ë Do të botohen në një vëllim aktet e konferencës me rezultatet shkencore të saj.

5. “Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë”;

Objektivat:

- Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës (temperatura e ajrit, lagështia absolute, presioni, intensiteti i rrezatimit diellor, etj.);
- Monitorimi i parametrave kryesorë të klimës, i kryer nga dy rrjetet kombëtare, ai i meteorologjisë dhe hidrologjisë me stafet përkatëse në INGJEUM, për gjithë vendin, ku përfshihen dhe rrethet Tiranë, Korçë, Vlorë e Shkodër;
- Analiza e lehtësive për projektuesit e sistemeve termodinamike, dizajnimin e klimës së brendshme të ndërtesave, komfortin termik, efiçencën e energjisë.

Produkti:

- Shkëmbimi i informacioneve lidhur me punimet, softet e përdorura për përpunimin e të dhënave dhe simulimeve përkatëse nëpërmjet postës elektronike;
- Grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave mbi parametrat kryesorë të klimës për rrethet përfaqësuese si Tirana, Korça, Vlora dhe Shkodra;
- Hartimi i pjesshëm i një botimi për klimën dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë.

6.“Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri”;

Objektivat:

- Ndërmarrja e studimeve me impakt në fuqizimin e institucioneve me krijimin e bashkëpunimeve midis dy vendeve, përsa i përket mbrojtjes së specieve bimore me rëndësi ekonomike nëpërmjet detektimit të hershëm të sëmundjeve virale;
- Përmirësimi i ekspertizës së kërkuesve të rinj në përdorimin e metodave bashkëkohore serologjike e molekulare të detektimit të fitopatologjive kryesore virale;
- Ndihmesë për autoritetet shqiptare dhe kosovare në vlerësimin e gjendjes së specieve frutore dhe hardhive për prodhimin e fidanëve të painfektuar, si brenda dhe jashtë të dy vendeve.

Produkti:

- Vazhdimi i hartimit të kapitujve të monografisë shkencore *Prodhimi dhe çertifikimi i fidanëve të painfektuar të dru-frutorëve, hardhisë, ullirit dhe agrumeve*, punë e përbashkët e të dyja grupeve (shqiptare dhe kosovare);

- Hartimi i kapitujve të veçantë të monografisë *Evidentimi i virozave të kultivarëve të mollës me anë të metodave të indeksit biologjik, serologjike dhe molekulare dhe shëndetësimi i materialit mbjellës në Kosovë dhe Shqipëri.*

7. “Mbrojtja e pemëve dhe hardhisë”;

Objektivat:

- Hulumtimi i sëmundjeve kërpudhore, bakteriale, virusale te pemët frutore dhe dëmtuesit e tyre, insekte dhe këpushat;

- Hulumtimi i sëmundjeve të hardhisë të shkaktuara nga kërpudhat, bakteriet, viruset, tiroidet dhe citoplazmat, si dhe të dëmtuesve të tyre, insekteve dhe këpushave;

Produkti:

- Botimi i monografisë *Mbrojtja e pemëve frutore dhe hardhisë nga dëmtuesit* për vitin 2013

8. SPALKO: Sistemet pastorale dhe kultura pastorale, trashëgimi në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe planifikimin e territorit”;

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

- Zhvillimi i një udhëzuesi për modelimin e menaxhimit të sistemeve pastorale dhe përcaktimi i treguesve për funksionimin dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së ekosistemeve pastorale në Shqipëri dhe Kosovë, me qëllim lidhjen në shkallë lokale si dhe transferimin e metodologjive dhe treguesve ndërmjet vendeve;

Objektivat:

- Vlerësimi i ndikimeve mbi klimën dhe ndryshimet në përdorimin e territorit në diversitetin e sistemeve pastorale;

- Vlerësimi i rrezikut të zjarreve në pyje dhe efektet e tyre në sistemet pastorale;

- Vlerësimi i të mirave dhe shërbimeve të sistemeve pastorale, duke përfshirë si ato të tregtueshme, edhe ato të patregtueshme.

Bazuar në përparësitë e strategjisë së Lisbonës, SPALKO synon të ndjekë ato që nxisin: (i) zhvillimin ekonomik; (ii) konkurrencën; (iii) punësimin.

Produkti:

- Hartimi i një guide- model për menaxhimin e sistemeve pastorale;
- Gjetja e treguesve për funksionimin dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemeve pastorale.

9. Fjalor shpjegues për mjedisin;

Objektivat:

- Hartimi i një fjalori të ri shpjegues me terma mjedisore duke plotësuar mungesën e ndjeshme që vihet re në këtë fushë;
- Hartimi i platformës së punës për përgatitjen e fjalësit.

Produkti:

- Kërkimi dhe sigurimi i burimeve të nevojshme bibliografike;
- Hartimi i modeleve të skedave për përgatitjen e fjalorit.

III. Realizim i projekteve dypalëshe e shumëpalëshe midis:

a) Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi (*IPA-Project of the Drini River-Shkodra Lake-Buna River Water System*);

b) Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (*bazuar në Marrëveshjen ndërmjet dy akademive*).

IV. Botime dhe përrurime

• Botimi i vëllimit me aktet e *Akademisë Solemne* kushtuar 100-vjetorit të Pavarësisë;

• Botimi i veprës *Fjalori shqip-greqisht dhe greqisht shqip* i Thimi Mitkos;

• Përrurimi i veprës *Bazat e virusologjisë bimore*, një lidhje e re e Institutit Agronomik Mesdhetar të Barit me bujqësinë shqiptare;

• Botimi i dy numrave të revistës shkencore *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS)*;

• Botimi i revistës *Journal Agriculture and Animal Production Science for Rural Development*,

- Botimi i *Raportit vjetor të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2012.*

V. Programi “Edukimi në Shkencë”

- Figura të shquara në shkencë;
- Organizimi i Seminarit shkencor “Bioteknologjia bimore në ndihmë të ekonomisë”
- Ditë të hapura të institucioneve shkencore.

VI. Tryeza të rrumbullakëta me grupe ekspertësh

- Dy tryeza për problemet mjedisore për liqenin e Ohrit dhe të Prespës (në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë).

IX. Synimet e Bibliotekës Shkencore

- Të vijojë puna për realizimin e Projektit ERA 2012;
- Të krijohet një *Bibliotekë me sistem të integruar*, që do të ofrojë baza web: meta-data; linke burimesh; kërkim të kryqëzuar bazash të dhënash;
 - me *informacion të disponueshëm*: Koleksione të printuara plus baza të dhënash; dokument delivery; E-burime të zgjeruara;
 - me *akses të lehtë në informacion*: printim sipas kërkesës i materialeve të bibliotekës *offline*;
 - me *udhëzime informative*: fletëpalosje, videokonferenca etj.

Veprimtaritë e parashikuara për t’u zhvilluar në vitin 2013 do të kushtëzohen nga burimet financiare që institucioni do të ketë në dispozicion.

SHTOJCA 1

DETYRAT KRYESORE TË AKADEMISË

- Akademia koordinon, mbështet dhe nxit kërkimin shkencor të anëtarëve të saj dhe në shkallë Republike.

- Nëpërmjet anëtarëve të saj dhe grupeve të specialistëve udhëheq projekte, kryen kërkime e studime me karakter teorik dhe të zbatuar në fusha të ndryshme të shkencave që mbulon, si dhe ndihmon për zbatimin e këtyre studimeve.

- Propozon hapjen e fushave të reja të kërkimeve e studimeve shkencore në përputhje me nevojat e zhvillimit të vendit.

- U ofron institucioneve të larta shtetërore këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të zhvillimit të vendit, si dhe jep mendimin për hartimin e ligjeve që lidhen me shkencën.

- Bashkëpunon me institucione e qendra të tjera shkencore publike e private brenda vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës.

- Vendos e zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shkencore të vendeve të tjera; ndihmon në bashkërendimin e veprimtarisë së organizmave të ndryshëm shkencorë, si dhe me organizata shkencore ndërkombëtare, për arritjen e një integrimi sa më të frytshëm të saj në shkencën botërore.

- Boton organe periodike të specializuara dhe vepra të tjera shkencore në të gjitha fushat e shkencës.

- Organizon kongrese e konferenca shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare.

- Kujdeset për rregullimin e raportit të zhvillimit të disiplinave shkencore dhe të përfaqësimit të tyre në Akademi, në përputhje me nevojat e vendit dhe me arritjet e shkencave në fusha të ndryshme.

- Formon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme me rëndësi kombëtare në mbështetje të strategjive për kërkim e zhvillim, për organizimin e studimeve ndërdisiplinore me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj dhe të studiuesve jashtë Akademisë.

- Organizon konkurse e dhënie çmimesh shkencore, lektoriume e promovime veprash, jep ose njih patentat në kërkimin shkencor, koncepton e realizon me të drejtën e autorit emisione radio-televizive, mbledh dhe informatizon të dhënat e punës shkencore etj.

- Kujdeset për të drejtat e anëtarëve të vet, të gjithë akademikëve si dhe të punonjësve të tjerë shkencorë, për krijimin e kushteve të përshtatshme jetësore e materiale për veprimtari shkencore.

ORGANET DREJTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

Organet drejtuese të Akademisë janë:

1. Asambleja

2. Këshilli Ekzekutiv

3. Kryesia e Akademisë

Asambleja është organi më i lartë drejtues i Akademisë. Ajo mbledhet të paktën, dy herë në vit. Në Asamble kanë të drejtë vote vendimore sipas ligjit, anëtarët e rregullt, të përhershëm dhe të asociuar të Akademisë.

- Asambleja shqyrton dhe miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë shkencore të Akademisë;

- vendos për çështje të tjera të rëndësishme me karakter shkencor e organizativ;

- miraton Statutin dhe ndryshimet që mund të bëhen në përmbajtjen e tij;

- zgjedh anëtarët e rinj të rregullt, të përhershëm, të asociuar e të nderit; zgjedh Kryesinë dhe kryetarët e seksioneve;

- shqyrton dhe miraton raportet e Kryesisë mbi veprimtarinë e përgjithshme të Akademisë;

- shqyrton probleme të zhvillimit perspektiv të shkencave në vend dhe u paraqet propozime organeve përkatëse.

Të gjitha çështjet zgjidhen nga Asambleja me votim të hapur dhe me shumicën e anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve kur në Statut parashikohet ndryshe.

Asambleja zgjedh me votim të fshehtë, për një mandat katërvjeçar kryetarin e Akademisë dhe zëvendëskryetarin dhe, për një mandat pesëvjeçar, sekretarin shkencor dhe kryetarët e seksioneve. Kryesia e Akademisë përbëhet nga tre anëtarë të Asamblesë: kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor.

Kryesia e Akademisë organizon, drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e Akademisë;

- vendos marrëdhënie e lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendëse e të huaja;
- vendos për mbledhjen e Asamblesë; miraton ndarjen e kuotave të buxhetit sipas fushave të veprimtarisë së Akademisë.

Kryesia e Akademisë ka aparatit e vet, i cili funksionon sipas rregullores së miratuar prej saj.

Kryetari i Akademisë përfaqëson Akademinë në marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe të shteteve të tjera, siguron lidhjet me organet shtetërore, thërret dhe drejton mbledhjen e Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Këshillit të Botimeve.

Në gjithë veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve të tij, kryetari ndihmohet nga zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor. Në rast mungese të kryetarit, zëvendëskryetari e zëvendëson në të gjitha funksionet e tij.

Zëvendëskryetari ndjek e bashkërendon punën e seksioneve, miraton programet e veprimtarisë së tyre kryesore organizative dhe ndihmon për mbarëvajtjen e tyre.


Sekretari Shkencor ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë, të Këshillit Ekzekutiv dhe të Kryesisë, përgatit mbledhjet e tyre, kujdeset për paraqitjen e programit shkencor të Akademisë dhe të raporteve për veprimtarinë e përgjithshme të saj, sipas programeve dhe raporteve të paraqitura nga seksionet e organizmat e tjerë, mbikëqyr veprimtarinë e aparatit administrativ të Akademisë.

Këshilli Ekzekutiv përbëhet nga 5 anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari, sekretari shkencor i Akademisë dhe kryetarët e seksioneve. Kryetari i Akademisë është edhe kryetar i Këshillit Ekzekutiv.

- Këshilli Ekzekutiv zbaton vendimet e Asamblesë;
- Shqyrton probleme të rëndësishme shkencore e organizative dhe merr vendimet përkatëse.
- Për gjithë veprimtarinë e tij, Këshilli Ekzekutiv raporton para Asamblesë.

Struktura organizative e AShSh pas reformimit paraqitet në skemën e mëposhtme

Organigrama e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



SHTOJCA 2

Veprimtaritë e mbështetura nga Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun gjatë vitit 2012:

- **Veprimtari sipas marrëveshjeve:**

- Në vijim të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit shkencor për vitet 2010-2015 midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve, në datat 18-20 janar 2012 bëri një vizitë pune në AShSh, presidenti i Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve, Prof. Felix Unger. Prof. Unger zhvilloi takime edhe me Kryeministrin e Shqipërisë, Prof. dr. Sali Berisha dhe me ministrin e Shëndetësisë, Dr. Petrit Vasili;

- Akad. Gudar Beqiraj, Kryetar i Akademisë, ka marrë pjesë në ceremoninë e përvjetorit të themelimit të Akademisë Europiane të Shkencave dhe të Arteve. Gjatë ceremonisë, atij iu akordua edhe titulli “Anëtar” i kësaj Akademie. Ceremonia u zhvillua në Salzburg të Austrisë më 3 mars 2012.

- Në kuadrin e zbatimit të Protokollit të Bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u zhvillua në Tiranë më 7 mars 2012 mbledhja e Këshillit Ndërakademik të Gjuhës Shqipe. Mbledhja e dytë u zhvillua në Tiranë më 27 qershor 2012.

- Në datat 19-21 mars 2012, në kuadrin e zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis dy akademive, Kryesia e Akademisë dhe anëtarë të saj, zhvilluan një vizitë pune në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, me qëllim paraqitjen në Maqedoni të arritjeve të shkencës shqiptare. Akademia u përfaqësua nga:

Akad. Gudar Beqiraj, kryetar

Akad. Muzaffer Korkuti, zëvendëskryetar

Akad. Salvator Bushati, sekretar shkencor

Akad. Emin Riza, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore

Akad. Dhimitër Haxhimihali, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike

Akad. Ethem Likaj, Anëtar i Akademisë;

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, organizoi në datën 28 maj 2012, paraqitjen e librit *Sëmundjet e pemëve frutore dhe të hardhisë*, me autorë Akad. Latif Susuri dhe Prof. i asoc. Arben Myrta;

- Në kuadër të Projektit të përbashkët për liqenin e Shkodrës të programit IPA, më 1 qershor 2012 u zhvillua në Tiranë takimi dypalësh midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Malit të Zi, për përcaktimin e aktiviteteve që duhen kryer në lidhje me zbatimin e veprimtarive të vitit të parë të projektit;

- Në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u organizua në Tiranë më 28 qershor 2012, paraqitja e librit *Shqipja dhe gjuhët ballkanike*, botuar në Prishtinë, me kumtesat e mbajtura në konferencën me të njëjtin titull;

- Në kuadrin e Protokollit të Bashkëpunimit midis dy akademive, kryetari i Akademisë, Akad. Gudar Beqiraj ka marrë pjesë në përrurimin e librit *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, që u zhvillua në Prishtinë më 7 shtator 2012 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

- Më 14 tetor u zhvillua në Ohër të Maqedonisë takimi i Këshillit të Përbashkët Shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Akademia jonë u përfaqësua nga Këshilli Ekzekutiv, i përbërë nga Akad. Gudar Beqiraj, Akad. Muzafer Korkuti, Akad. Salvator Bushati, Akad. Dhimitër Haxhimihali.

- **Veprimtari jashtë marrëveshjeve:**

- Akad. Gudar Beqiraj, kryetar i Akademisë, mori pjesë në ceremoninë që u zhvillua në Bari të Italisë më 24 shkurt 2012, me rastin e dorëzimit të albumit “Ismail Qemali”, botuar me financimin e palës italiane;

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi më 2 mars 2012 paraqitjen e librit publicistiko-letrar *Sekretet e gazetarëve të RTSH-së*, të shkrimtarit dhe publicistit Albert Zholi;

- Akad. Salvator Bushati, sekretar shkencor i Akademisë, ka marrë pjesë në seminarin “Strategjia e Ballkanit Perëndimor për përtëritjen e strategjisë së kërkim-zhvillimit”, që u zhvillua më 26-28 mars 2012 në Sarajevë të Bosnje-Herzegovinës. Seminari u organizua nga Banka Botërore;

- Kryesia e Akademisë propozoi Akad. Kristo Frashërin si kandidat për çmimin “Princi i Asturias 2012” në fushën e “Shkencave Shoqërore- dega Histori”;
- Akademia organizoi më 17 mars 2012 homazhet me rastin e vdekjes së anëtarit të Akademisë, Akad. Zija Xholit;
- Më 13 prill 2012, Akademia e Shkencave organizoi ceremoninë e dhënies së Medaljes “Nderi i Akademisë” ambasadorit Silvano Pedrollo, si edhe përrurimin e dokumentarit televiziv: “Silvano Pedrollo, një mik i shqiptarëve”, realizim i Televizionit Shqiptar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë;
- Më 16 prill 2012, Akademia e Shkencave organizoi ceremoninë e dhënies së Medaljes “Nderi i Akademisë” kampionit të Europës në peshëngritje, Z. Erkand Qerimaj;
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi më 18 prill 2012, paraqitjen e botimit “Ismail Qemali”, album me foto dhe tekste. Ky album i kushtohet figures së Ismail Qemalit, i cili vuri gurin e parë në themelimin e shtetit kombëtar të pavarur shqiptar më 28 Nëntor 1912. Albumi është përgatitur nga Akad. Kristo Frashëri;
- Akademia organizoi më 24 prill paraqitjen e librit *Sfidat e poetit* kushtuar anëtarit të Akademisë, shkrimtarit Akad. Xhevahir Spahiu;
- Më 13 maj 2012, në Neuchatel të Zvicrës u zhvillua Olimpiada e parë e Dancit për fëmijë e të rinj. Me ftesë të organizatorëve të kësaj olimpiade, disa prej të cilëve ishin shqiptarë, mori pjesë edhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akad. Gudar Beqiraj, sepse, ndër të tjera, kjo olimpiadë ishte edhe një lloj prezantimi i imazhit të Shqipërisë në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë;
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës, organizoi më 31 maj 2012 paraqitjen e librit *Bimët dhe Shqiptarët*, të Prof. dr. Lufter Xhuvelit;
- Akad. Salvator Bushati, sekretar shkencor i Akademisë, ka marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare “Shkencat shoqërore dhe bota e sotme”, që u zhvillua më 7-9 qershor 2012 në Podgoricë të Malit të Zi;
- Kryetari i Akademisë, Akad. Gudar Beqiraj, mori pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare “Roli i diasporës në shtetformimin e Shqipërisë dhe të Kosovës”, që u mbajt më 10 deri më 13 qershor 2012 në Prizren të Kosovës, me qëllim paraqitjen e botimit të Akademisë “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” me autor Akad. Kristo Frashëri. Konferenca u organizua nga Ministria e Diasporës e

Qeverisë së Republikës së Kosovës, së bashku me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës dhe Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Nga Akademia ishin të pranishëm gjithashtu Akad. Vasil Tole dhe Akad.i asoc. Gjovalin Shkurtaj;

- Akad. Jani Thomai u caktua të marrë pjesë në Konferencën shkencore “Shekulli i shtetit shqiptar”, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Konferenca u zhvillua në Prishtinë të Kosovës më 11-12 qershor 2012;

- Akad. Jani Thomai mori pjesë gjithashtu në Konferencën shkencore “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe - vepër me vlera të mëdha kombëtare”, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve. Konferenca u zhvillua në Shkup të Maqedonisë më 13 qershor 2012;

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, organizoi më 11 korrik 2012, një takim në nderim të Akad. Sotir Kuneshka, me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij;

- Në kuadrin e festimeve për 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, më 7 shtator 2012 Akademia e Shkencave dhe e Arteve shqiptaro-amerikane në ShBA organizoi në Akademinë tonë një kumtim shkencor me referues Prof. Bajram Dokën kushtuar *Epigrafisë Iliro-Pellazge*;

- Në kuadrin e veprimtarive për kremtimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, kryetari i Akademisë, Akad. Gudar Beqiraj dhe zëvendëskryetari, Akad. Muzafer Korkuti, morën pjesë në Konferencën shkencore: “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas”, që u zhvillua në Prishtinë më 13-14 shtator 2012, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

- Akad. Gudar Beqiraj, kryetari i Akademisë u ftua për të marrë pjesë në ceremoninë e ndarjes së diplomave në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës. Ceremonia u zhvillua më 23 shtator 2012;

- Akad. Floresha Dado ka marrë pjesë në Konferencën kushtuar 100-vjetorit të lindjes së A. V. Desnickaya, që u zhvillua në Shën Peterburg të Rusisë më 27 shtator - 3 tetor 2012 në mjediset e Institutit të Studimeve Gjuhësore pranë Akademisë së Shkencave të Rusisë;

- Më 11 tetor 2012, kryetari i Akademisë, Akad. Gudar Beqiraj mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të brezit të 6-të të studentëve të kolegjit “Iliria” të Prishtinës;

- Më 17 tetor, kryetari i Akademisë, Akad. Gudar Beqiraj mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, pranë Kolegjit “Iliria” të Prishtinës;

- Sekretari shkencor i Akademisë, Akad. Salvator Bushati ndoqi punimet e Konferencës “Komunitetet fetare në Shqipëri – një bashkëjetesë e mundshme”, organizuar në Itali më 18-19 tetor 2012, nga Departamenti i Shkencave Juridike të Universitetit të Ravenës;

- Zëvendëskryetari i Akademisë, Akad. Myzafer Korkuti mori pjesë në konferencën “Ditët kulturore shqiptare”, të organizuar në Zvicër më 19-22 tetor, nga Universiteti i Gjenevës;

- Gjatë muajit nëntor janë bërë përgatitjet për organizimin e festimit të 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si edhe për Konferencën për 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë. Veprimtaritë janë pasqyruar në faqen e Akademisë në internet;

- Zëvendëskryetari i Akademisë, Akad. Myzafer Korkuti mori pjesë në Konferencën ndërkombëtare me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, organizuar në Moskë më 3-6 dhjetor 2012.

Të tjera:

Në panairot e librit shqiptar që janë organizuar në Kosovë dhe Maqedoni, janë ekspozuar botime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

• Vizita në Kryesinë e Akademisë:

- Më 22 shkurt 2012 bëri një vizitë në Kryesinë e Akademisë zëvendës-presidenti i Parlamentit Europian, Z. Gianni Pitella;

- Më 19 prill 2012, u zhvillua një takim i Kryesisë së Akademisë me ministrin e Diasporës së Republikës së Kosovës, Z. Ibrahim Makolli. Qëllimi i vizitës ishte diskutimi dhe bashkërendimi i veprimtarive për kremtimin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë;

- Më 19 prill 2012, Kryesia e Akademisë zhvilloi një takim me drejtoren e Përgjithshme të Fondacionit “RYDER” për Mbretërinë e Bashkuar, Zj. Helen Organ;

- Në datën 23 maj 2012, u zhvillua një takim midis Kryesisë së Akademisë sonë dhe ambasadorit të Federatës Ruse, Leonid Abramov. Qëllimi i vizitës së Z.

Abramov ishte diskutimi rreth bashkëpunimit të ardhshëm në fushën e shkencës midis Akademisë sonë dhe Akademisë ruse;

- Në datën 19 qershor 2012, kryetari i Akademisë pati një takim me presidentin e Fondacionit Italo-Shqiptar për Pajisjet e Komunikimit Elektronik, Z. Stefano Berardi.

- **Të tjera**

Pjesë e punës së Degës së Marrëdhënieve me Jashtë kanë qënë edhe:

- njoftimet për mediat për të gjitha veprimtaritë gjatë vitit;
- ndjekja e pagesave të kuotave të anëtarësimit në organizmat shkencorë ndërkombëtarë;
- ndjekja e procedurave të kortsizisë;
- hartimi i shkresave administrative (vërtetime, etj.);
- përkthime të ndryshme.

- **Veprimtari në vazhdim për vitin e ardhshëm:**

Përgatitjet për 2013 të konferencës së AIESEE dhe për mbledhjet vjetore të IAP, ALLEA, etj, nëse do të ekzistojnë mundësitë financiare për vitin e ardhshëm.

SHTOJCA 3

LISTA E ANËTARËVE TË RREGULLT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË

A) Me titullin “Akademik”

<i>Nr</i>	<i>Mbiemër</i>	<i>Emër</i>	<i>Fusha</i>
1	ANGJELI	Anastas	Ekonomi
2	BAÇE	Apollon	Arkeologji
3	BEQIRAJ	Gudar	Matematikë-Informatikë
4	BULO	Jorgo	Letërsi
5	BUSHATI	Salvator	Gjeofizikë
6	DADO	Floresha	Letërsi
7	DEMIRAJ	Shaban	Gjuhësi
8	DOJA	Albert	Antropologji
9	ELEZI	Besim	Mjekësi
10	FRASHËRI	Neki	Matematikë-Informatikë
11	FUGA	Artan	Sociologji
12	GRUDA	Nazim	Bujqësi
13	GJINUSHI	Skënder	Matematikë
14	HAXHIMIHALI	Dhimitër	Kimi
15	KAÇANI	Jorgaq	Mekanikë
16	KASTRATI	Adnan	Mjekësi
17	KONGOLI	Fatos	Letërsi
18	KORKUTI	Muzafer	Arkeologji
19	LIKAJ	Ethem	Gjuhësi
20	MEJDANI	Rexhep	Fizikë
21	MERKOÇI	Arben	Kimi
22	META	Beqir	Histori
23	PETRO	Petraç	Matematikë
24	RESULI	Bashkim	Mjekësi
25	RIZA	Emin	Arkeologji
26	SPAHIU	Xhevahir	Letërsi

27	TOLE	Vasil	Muzikologji
28	TOPALLI	Kolec	Gjuhësi
29	VANGJELI	Jani	Biologji
30	VILA	Floran	Fizikë

B) Me titullin “Akademik i asociuar”

<i>Nr</i>	<i>Mbiemër</i>	<i>Emër</i>	<i>Fusha</i>
1	ANASTASI	Aurela	Drejtësi
2	BAJRABA	Kosta	Sociologji
3	DURRËSI	Arjan	Teknologji informacioni
4	KONDILI	Anesti	Mjekësi
5	KONGJIKA	Efigjeni	Biologji
6	MALOLLARI	Ilirian	Kimi Industriale
7	PINGULI	Edmond	Ndërtim
8	SHKURTAJ	Gjovalin	Gjuhësi
9	THERESKA	Nestor	Mjekësi
10	VERLI	Marenglen	Histori
11	VEVEÇKA	Afërdita	Fizikë

LISTA E AKADEMIKËVE NË PENSION

<i>Nr</i>	<i>Mbiemër</i>	<i>Emër</i>	<i>Fusha</i>
1	AGOLLI	Dritëro	Letërsi
2	BECI	Bahri	Gjuhësi
3	FRASHËRI	Kristo	Histori
4	GOLEMI	Bardhyl	Elektronikë
5	GJERGJI	Andromaqi	Etnologji
6	HOXHA	Farudin	Hidroteknikë
7	KADARE	Ismail	Letërsi
8	MISJA	Vladimir	Ekonomi

9	OMARI	Luan	Drejtësi
10	PËRMETI	Mentor	Agronomi
11	POPA	Ylli	Mjekësi
12	PRIFTI	Kristaq	Histori
13	PUTO	Arben	Drejtësi
14	SULSTAROVA	Eduard	Gjeofizikë
15	TIRTA	Mark	Etnologji
16	THOMAI	Jani	Gjuhësi
17	UÇI	Alfred	Estetikë

LISTA E ANËTARËVE TË NDERIT

<i>Nr</i>	<i>Mbiemër</i>	<i>Emër</i>	<i>Shteti</i>
1	A.FRIEDMAN	Victor	SHBA
2	AJETI	Idriz	Kosovë
3	ALIU	Ali	Kosovë
4	ALTIMARI	Francesco	Itali
5	AUBOUIN	Jean	Francë
6	BARTL	Peter	Gjermani
7	CABANES	Pierre	Francë
8	CASTELLAN	Georges	Francë
9	DJUROVIC	Momir	Mal i Zi
10	DUCELLIER	Alain	Francë
11	FIEDLER	Wilfried	Gjermani
12	GUILLOU	Andre	Francë
13	HAMP	Eric	SHBA
14	INALÇIK	Halil	Turqi
15	ISMAJLI	Rexhep	Kosovë
16	J.D.DRENTH	Pieter	Holandë
17	J.FISCHER	Bernd	SHBA
18	KRASNIQI	Mark	Kosovë
19	MANG	Herbert	Austri

20	MATEVSKI	Mateja	Maqedoni
21	MURATI	Ferid	SHBA
22	QOSJA	Rexhep	Kosovë
23	QUERE	Yves	Francë
24	STAROVA	Luan	Maqedoni
25	SVANE	Gunnar	Danimarkë
26	TEODORESCU	Razvan	Rumani